



KOSOVA DHE FRANCA NËNSHKRUAJNË PESË MARRËVESHJE NDËRSHTETËRORE

FRANCA MBËSHTET ANËTARËSIMIN E KOSOVËS NË KËSHILLIN E EVROPËS

FAQE 4-5



Kosova dhe Franca kanë shënuar një hap të ri në forcimin e marrëdhënieve dypalëshe përmes nënshkrimit të pesë marrëveshjeve që përfshijnë fusha me rëndësi strategjike për të dyja vendet. Marrëveshjet synojnë ta zgjerojnë

bashkëpunimin ekonomik, energjetik dhe arsimor, ndërsa përfshijnë edhe mbështetjen për përgatitjet e Kosovës për Lojërat Mesdhetare 2030. Glauk Konjufca dhe Benjamin Haddad kanë vlerësuar marrëdhëniet Kosovë - Francë,

duke theksuar gatishmërinë për thellimin e mëtejshëm të partneritetit, përfshirë edhe perspektivën evropiane të Kosovës. Në këtë kontekst, ministri francez ka deklaruar se Franca mbështet Kosovën për anëtarësim në Këshillin e Evropës

HAXHIU PRITET TË PROPOZOHET SËRISH NGA LV-JA PËR KRYETARE TË KUVENDIT F. 3



KUVENDI I JASHTËZAKONSHËM I LDK-së DO TË MBAHET TË ENJTEN F. 5



OPINION

PËRNDJEKJA E ÇLIRIMTARËVE F. 5

Shkruan: Prof. Agim R. ZOGAJ



AKTUALE




KONJUFCA: SPECIALJA TË MOS MARRË VENDIM POLITIK. DO TË ISHIM SHUMË TË REVOLTUAR NËSE LIDERËT E UÇK-së DO TË DËNOHESHIN F. 5

SULMI NË 'IBËR-LEPENC' SHKAKTOI MBI 376 MIJË EURO DËME F. 7

HAPET APLIKIMI PËR SUBVENCIONIMIN E TEKSTEVE DHE MATERIALEVE SHKOLLORE F. 6

EKONOMI



ÇFARË FSHIHET PAS FORCIMIT REKORD TË LEKUT? F. 8

SPORT



SUPERLIGA E KOSOVËS NIS ME DERBIN PRISHTINA - BALLKANI F. 11

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Irani ndal sulmet hakmarrëse ndaj aleatëve të ShBA-së, por tensionet mbeten të larta

TEHERAN, 27 KORRIK - Teherani zyrtar ka njoftuar se ka ndalur sulmet hakmarrëse kundër aleatëve të Shteteve të Bashkuara në Lindjen e Mesme, teksa Uashingtoni është përmbytur nga sulmet ndaj Iranit për natën e dytë radhazi. Ndërsa një zyrtar i lartë ushtarak në Teheran ka kërcënuar se Irani

mund t'i zgjerojë sulmet në mbarë rajonin, duke lënë të kuptohet se rebelët Houthis në Jemen, të mbështetur nga Irani, mund t'i shtojnë sulmet ndaj anijeve që lundrojnë në Detin e Kuq. Qetësia ka ardhur para një takimi kyç të planifikuar në Uashington në mes të presidentit amerikan Donald

Trump dhe kryeministrit izraelit Benjamin Netanyahu. Vizita e sotme e Netanyahu përkon saktësisht me pesëmujorin e nisjes së një fushate të gjerë sulmesh ajrore ndaj caqeve iraniane nga forcat amerikane dhe izraelite. Irani është kundërpërgjigjur duke sulmuar aleatët e ShBA-së në Lindjen e

Mesme dhe praktikisht e ka mbyllur ngushticën e Hormuzit, rrugën strategjike detare përmes së cilës rëndom kalon një sasi e madhe nafte dhe gazi drejt tregjeve botërore. Në javët e fundit Uashingtoni ka shpallur një armëpushim të pjesshëm, megjithëse para 24 korrikut kishte kryer bombardime të



pandërprera ndaj caqeve iraniane për pothuajse dy javë.

FRANCË: TESTE DROGE PËR ZYRTARËT E MINISTRIVE

PARIS, 27 KORRIK - Franca ka nisur zbatimin e masave të rrepta kundër përdorimit të drogës në administratën shtetërore. Sipas kryeministrit francez Sebastien Lecornu, testimet janë të nevojshme për arsye sigurie, pasi një pjesë e punonjësve kanë qasje në informacione jashtëzakonisht të ndjeshme. Kryeministri francez Sebastien Lecornu kishte njoftuar disa javë më parë se në ministri do të zhvilloheshin teste të papritura dhe të paparalajmëruara për përdorimin e drogave, një vendim që shkaktoi debat të gjerë. Tashmë janë raportuar edhe rastet e para të largimeve nga puna. Sipas agjencisë së lajmeve “DPA”, disa punonjës të ministrive janë detyruar të largohen nga detyra pasi rezultatet e testeve të tyre kanë rezultuar pozitive. Lecornu e ka konfirmuar këtë në një intervistë për revistën “Paris Match”. “Shumë thonë se e bëra këtë për të dhënë një shembull në Francë. Kjo është e vërtetë. Por, mbi të gjitha, e bëra për arsye sigurie”, ka deklaruar Lecornu. Ai ka theksuar se shumë prej punonjësve të testuar kanë qasje në informacione jashtëzakonisht të ndjeshme, ndaj përdorimi i drogës përbën rrezik për sigurinë dhe funksionimin e shtetit. Në mes të muajit qershor, Lecornu u kishte dërguar ministrive një qarkore, përmes së cilës urdhëronte teste të detyrueshme dhe të paparalajmëruara të pëshqyrtimit për zbulimin e përdorimit të drogave. Sipas medieve franceze, ai kishte kërkuar që të kontrolloheshin



anëtarët e ministrive, zyrtarët e lartë shtetërorë dhe personeli që u nënshtrorhet verifikimeve të sigurisë. Në qarkore është thënë se, në rast se rezultatet e testeve do të dilnin pozitive, autoritetet përkatëse duhej t'i shqyrtonin pasojat e mundshme, përfshirë edhe masat disiplinore ndaj punonjësve.

Shteti duhet të mbetet i besueshëm në luftën kundër drogës

Përveç mbrojtjes së informacioneve të ndjeshme në

nivelet më të larta të administratës shtetërore, një tjetër arsye për testet e drogës në qeveri është dëshira që shteti ta ruajë besueshmërinë në luftën kundër kriminalitetit të lidhur me drogën. Siç ka deklaruar Sebastien Lecornu për revistën “Paris Match”, trafiku i drogës përbën “sfidën më të madhe të politikës së brendshme me të cilën vendi ynë po përballlet aktualisht dhe do të përballlet edhe në vitet e ardhshme”. Ai ka thënë se në Francë ka pothuajse një milion konsumues drogë. “Kjo prek të gjitha shtresat e shoqërisë”, ka

thënë Lecornu. Sipas tij, as bota politike nuk është e imunizuar ndaj këtij fenomeni. Kryeministri francez ka theksuar se lufta e shtetit kundër drogës mund të mbetet e besueshme vetëm nëse ata që e udhëheqin atë nuk lënë vetë shkak për dyshim. Sipas tij, në trajtimin e problemit nuk mund të ketë standarde të dyfishta. “Nuk mund t'i dënojmë vrasjet e 16-vjeçarëve në periferitë e qyteteve dhe në të njëjtën kohë ta tolerojmë konsumimin e drogës në lagjet e pasura”, ka thënë ai. Me këtë qëndrim, qeveria franceze synon ta japë sinjalin se

lufta kundër drogës duhet të zbatohet njësoj për të gjithë, pavarësisht statusit shoqëror apo pozicionit politik.

Kontrollet do të vazhdojnë

Sipas kryeministrit francez Sebastien Lecornu, testet e drogës në qeveri dhe ministri nuk janë një masë e përkohshme apo simbolike. “Testet do të kryhen në mënyrë rastësore dhe do të vazhdojnë. Nuk kam asnjë dyshim se pasardhësit e mi mund të shkojnë madje edhe më tej”, ka deklaruar ai. Kjo do të thotë se kontrollet e paparalajmëruara do të vazhdojnë të jenë pjesë e mekanizmave të sigurisë në administratën shtetërore franceze, me qëllim parandalimin e përdorimit të drogës nga zyrtarët dhe punonjësit që kanë përgjegjësi të rëndësishme. Ndërkohë, ekipet e testimit të drogës kanë shkuar pa paralajmërim edhe në “Hotel de Matignon”, selinë e qeverisë franceze. Sipas televizionit “TF1”, rezultatet e testeve kanë qenë lehtësuese për ekzekutivin francez: kryeministri dhe bashkëpunëtorët e tij kanë rezultuar negativë, pra nuk kishin përdorur drogë. Kjo nismë është pjesë e përpjekjeve më të gjera të qeverisë franceze për ta forcuar luftën kundër drogës dhe për të garantuar që zyrtarët publikë t'i përmbushin standardet që shteti kërkon nga qytetarët e tij.

Ukraina dhe ShBA-ja përgatitin propozim të ri paqeje për Rusinë

KIEV, 27 KORRIK - Ukraina dhe Shtetet e Bashkuara po shqyrtojnë propozime të reja për një marrëveshje me Rusinë, që synon ndaljen e sulmeve ajrore dhe ringjalljen e negociatave për paqe. Propozimi pritet t'i paraqitet Moskës si pjesë e një nisme të

re diplomatike për rikthimin e palëve në tryezën e negociatave. Një burim ukrainas, i cili nuk është identifikuar, ka konfirmuar për “Reuters” se zyrtarët ukrainas dhe ata amerikanë kanë diskutuar tashmë për hollësitë e kësaj nisme. Ukraina edhe më

herët i kishte paraqitur presidentit rus, Vladimir Putin, propozime për armëpushim, por ato ishin refuzuar nga presidenti rus. Megjithatë, disa zyrtarë besojnë se presioni ndaj ekonomisë ruse, i shkaktuar nga sulmet e vazhdueshme me dronë dhe raketa nga Ukraina,

mund të ndikojë në qëndrimin e Putinit. Propozimet e reja të mundshme vijnë pas një serie aktiviteteve të fundit diplomatike. Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky ka zhvilluar më 22 korrik një bisedë telefonike me të dërguarit amerikanë Steve



Witkoff dhe Jared Kushner, me të cilët ka diskutuar për forcimin e përpjekjeve diplomatike.

E VËRTETA E TAKIMEVE TË HERSHME TË LPK-së ME RUGOVËN

PRISHTINË, 27 KORRIK - Ish-përfaqësuesit e Lëvizjes Popullore të Kosovës (LPK), Azem Syla dhe Ramadan Avdiu, kanë reaguar ndaj deklaratave të ish-nënkryetarit të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Anton Kola, të bëra në emisionin “Fakte” me Adnan Merovcin të transmetuar më 23 prill 2026.

Në reagimin e tyre, Syla dhe Avdiu kanë thënë se ish-nënkryetari i LDK-së, Anton Kola, në një rast (nga minuta e 31), në mungesë të informacioneve, të njohurive apo me qëllim të caktuar në vend të nxjerrjes së fakteve, i ngatërron ato duke devijuar tërësisht qëllimin e takimeve në mes të përfaqësuesve të Lëvizjes Popullore të Kosovës (LPK) me Ibrahim Rugovën dhe bisedat e pasuara më vonë në takime në mes të Azem Sylës dhe Anton Kolës. Sipas tyre, takimet e mbajtura nga prilli deri në tetor të vitit 1991 nuk ishin takime të disa ish-të burgosurve politikë me Rugovën, por takime të rregullta ndërmjet LPK-së dhe LDK-së, me synim bashkëpunimin e aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve mbrojtëse dhe të sigurisë kundër okupatorit serb.

“Takimet e zhvilluara nga muaji prill deri në tetor të vitit 1991, në mes të përfaqësuesve të Lëvizjes Popullore të Kosovës Xhavit Haziri, Azem Syla dhe Ramadan Avdiu, nuk kanë qenë siç deklaroi z. Kola; një takim i disa të burgosurve politik me z. Rugova në banesën e tij në Lakrishtë, por takime të rregullta në mes të LPK-së dhe LDK-së, me qëllim të bashkëpunimit dhe koordinimit të aktiviteteve për krijimin e kapaciteteve për veprim kundër okupatorit serb, sidomos në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”, është thënë në reagimin e Sylës dhe të Avdiut. Në reagim është thënë se e vërteta e ndërprerjes së komunikimit në mes të përfaqësuesve të LPK-së dhe LDK-së, në prag të themelimit të Qeverisë së Kosovës të kryesuar nga Bujar Bukoshi, ka qenë: “Sepse z. Anton Kola ka insistuar të di çdo detal për LPK-në e cila vepronte në

fshehtësi të thellë; Strukturën organizative, kuadrin udhëheqës, shtrirjen e saj, pajisjet që posedon dhe financat. Kjo ishte e papranueshme për atë kohë, sepse natyra e organizimit të LPK-së ishte e tillë sa ato informacione sidomos strukturën organizative dhe pajisjet që posedonte, nuk i dinin as të gjithë anëtarët e Kryesisë së LPK-së e lëre më dikush jashtë organizimit të saj”.

Në reagimin e tyre, Syla dhe Avdiu kanë thënë se tendencat për të krijuar narracion historik jo të bazuar në argumente dhe për t'i paraqitur si fakte janë anakronike dhe antihistorike, sikurse edhe përpjekjet e shndërrimit të dëshirave në argumente historike, me qëllim të ngatërimit të fakteve, fenomeneve dhe të protagonistëve që e bënë dallimin në historinë e çlirimit të Kosovës!

Reagimi i plotë:

Në një bisedë në kuadër të emisionit “Fakte” me Adnan Merovcin, të emituar më 23 prill 2026, ish-nënkryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës z. Anton Kola, në një rast (nga minuta e 31), në mungesë të informacioneve, të njohurive apo me qëllim të caktuar në vend të nxjerrjes së fakteve i ngatërron ato duke devijuar tërësisht qëllimin e takimeve në mes të përfaqësuesve të Lëvizjes Popullore të Kosovës me z. Rugova dhe bisedat e pasuara më vonë në takime në mes të z. Azem Sylës dhe të z. Anton Kolës.

Lidhur me deklarinimin e z. Anton Kola për takimet që kemi zhvilluar ne, përfaqësuesit e Lëvizjes Popullore të Kosovës, me kryetarin e LDK-së dhe të Kosovës z. Ibrahim Rugova, për hir të së vërtetës historike deklarojmë me sa vijon.

1. Takimet e zhvilluara nga muaji prill deri në tetor të vitit 1991, në mes të përfaqësuesve të Lëvizjes Popullore të Kosovës Xhavit Haziri, Azem Syla dhe Ramadan Avdiu, nuk kanë qenë siç deklaroi z. Kola; një takim i disa të burgosurve politik me z. Rugova në banesën e tij në



Lakrishtë, por takime të rregullta në mes të LPK-së dhe LDK-së, me qëllim të bashkëpunimit dhe koordinimit të aktiviteteve për krijimin e kapaciteteve për veprim kundër okupatorit serb, sidomos në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë.

2. Në një takim në muajin shtator të vitit 1991, z. Rugova ka theksuar se do të tentojmë të formojmë Qeverinë e Kosovës dhe është interesuar të dijë nëse LPK-ja si organizatë politiko-ushtarake që vepronte në fshehtësi të thellë është e interesuar të përfshihet në Qeveri. Ne kemi shfaqur interesim të përfshihemi në Ministrinë e Mbrojtjes.

3. Në takimin e radhës pas një jave, z. Rugova pasi ishte konsultuar me bashkëpunëtorët e tij theksoi se për shkak të formës së veprimit që e ka LPK-ja, do të ishte më mirë të mos përfshihet drejtpërdrejtë në Qeveri, por të ketë komunikim me Qeverinë përmes një ndërmjetësuasi dhe na ka propozuar tre emra me të cilët do të mund të komunikojmë. Z. Anton Kola, Dr. Shaqir Shaqiri ose me z. Neriman Braha.

4. Meqë Azem Syla është njohur personalisht me z. Anton Kola, janë takuar dhe kanë biseduar lidhur me gatishmërinë e LPK-së për të dhënë kontributin saj në ngritjen e kapaciteteve

mbrojtëse. Nuk është e vërtetë se z. Azem Syla në këto takime t'i ketë thënë z. Anton Kola siç pohon ai në emisionin “Fakte”, se ne (LPK-ja) nuk mund të bashkëpunojmë me z. Ibrahim Rugova. Kjo është plotësisht e pavërtetë dhe gënjeshtër e kulluar.

Sikur të ishte ashtu ne fare nuk do të ishim takuar disa herë me z. Rugova nga muaji prill deri në tetor, dhe ndonëse kemi pasur dallime konceptuale kemi shpresuar se do të mund të jemi komplementar në veprimtari antipushtuese.

5. E vërteta e ndërprerjes së komunikimit në mes të përfaqësuesve të LPK-së dhe LDK-së, në prag të themelimit të Qeverisë së Kosovës të kryesuar nga Bujar Bukoshi, ka qenë; sepse z. Anton Kola ka insistuar të di çdo detal për LPK-në e cila vepronte në fshehtësi të thellë; Strukturën organizative, kuadrin udhëheqës, shtrirjen e saj, pajisjet që posedon dhe financat. Kjo ishte e papranueshme për atë kohë, sepse natyra e organizimit të LPK-së ishte e tillë sa ato informacione sidomos strukturën organizative dhe pajisjet që posedonte, nuk i dinin as të gjithë anëtarët e Kryesisë së LPK-së e lëre më dikush jashtë organizimit të saj. Anomalia e pohimeve të z. Kola në këtë emision konsiston në

deklarimin e tij, se përderisa rreth shtabeve komunale të LDK-së siç thekson ai, nuk është interesuar të njohë dhe të dijë asgjë jashtë rrethit të Klinës, për LPK-në ka kërkuar dhe insistuar të dijë gjithçka... Madje pranimi i z. Gani Veseli për të qenë në krye të shtabit komunal në Klinë është bërë pas konsultimeve që i ka pasur z. Veseli me Azem Sylën dhe në vazhdimësi është konsultuar dhe ka marrë direktiva nga Azem Sylë.

Pasi është themeluar Qeveria ne i kemi rralluar takimet me z. Rugova, kurse pas dështimit të Qeverisë së Bukoshit dhe LDK-së, për krijimin e strukturave mbrojtëse në Kosovë, LPK-ja, ka shtuar angazhimin për përgatitjen e njësiteve ushtarake për të shkuar drejt themelimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Tendencat për të krijuar narracion historik jo të bazuar në argumente dhe për t'i prezantuar si fakte janë anakronike dhe antihistorike, sikurse edhe përpjekjet e shndërrimit të dëshirave në argumente historike, me qëllim të ngatërimit të fakteve, fenomeneve dhe të protagonistëve që e bënë dallimin në historinë e çlirimit të Kosovës!

Azem Sylë

Ramadan Avdiu

Haxhiu pritët të propozohet sërish nga LV-ja për kryetare të Kuvendit



PRISHTINË, 27 KORRIK - Albulena Haxhiu do të propozohet sërish nga Lëvizja Vetëvendosje për kryetare të Kuvendit të Kosovës. Lajmin e ka bërë me dije ministri në detyrë i Punëve të Jashtme, Glauk Konjufca. Ai ka thënë se, ndonëse këtë çështje ende nuk e kanë diskutuar, emri i

Haxhiut pritët të vendoset në mbledhjen e radhës të kryesisë së kësaj partie. “Jo, deri tash nuk e kemi biseduar atë çështje, por këto do të merren brenda organeve të Vetëvendosjes. Në mbledhjen e ardhshme të Kryesisë, me gjasë, do të vendoset gjithçka. Por, unë mendoj se kryetaren

e Kuvendit e kemi tashmë të vendosur. Ajo është zonja Haxhiu dhe, me gjasë, ky do të jetë po ashtu propozimi i njëjtë”, ka deklaruar Konjufca.

Seanca për konstituimin e legjislaturës së re të Kuvendit të Kosovës është thirrur për 6 gusht.



KOSOVA DHE FRANCA NËNSHKRUAJNË PESË MARRËVESHJE NDËRSHTETËRORE

FRANCA MBËSHTET ANËTARËSIMIN E KOSOVËS NË KËSHILLIN E EVROPËS

Kosova dhe Franca kanë shënuar një hap të ri në forcimin e marrëdhënieve dypalëshe përmes nënshkrimit të pesë marrëveshjeve që përfshijnë fusha me rëndësi strategjike për të dyja vendet. Marrëveshjet synojnë ta zgjerojnë bashkëpunimin ekonomik, energjetik dhe arsimor, ndërsa përfshijnë edhe mbështetjen për përgatitjet e Kosovës për Lojërat Mesdhetare 2030. Glauk Konjufca dhe Benjamin Haddad kanë vlerësuar marrëdhëniet Kosovë - Francë, duke theksuar gatishmërinë për thellimin e mëtejshëm të partneritetit, përfshirë edhe perspektivën evropiane të Kosovës. Në këtë kontekst, ministri francez ka deklaruar se Franca mbështet Kosovën për anëtarësim në Këshillin e Evropës

EPOKA E RE**Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 27 KORRIK - Kosova dhe Franca kanë thelluar bashkëpunimin dypalësh me nënshkrimin e pesë marrëveshjeve të reja të cilat synojnë forcimin e partneritetit në fusha të ndryshme, nga zhvillimi ekonomik dhe energjia deri tek arsimi dhe përgatitjet për Lojërat Mesdhetare 2030. Pas ceremonisë së nënshkrimit, ministri në detyrë i Punëve të Jashtme, Glauk Konjufca, e ka cilësuar Francën një nga partnerët më të rëndësishëm të Kosovës që nga shpallja e pavarësisë, ndërsa ministri i Deleguar për Evropën i Francës, Benjamin Haddad, ka rikonfirmuar mbështetjen e Parisit për zhvillimin dhe perspektivën evropiane të Kosovës. Konjufca ka deklaruar se Republika e Kosovës ka dëshmuar

përkushtimin e palëkundur ndaj reformave demokratike, sundimit të ligjit dhe përafrimit të politikave të saj të jashtme dhe të sigurisë me Bashkimin Evropian. “Franca, qysh prej shpalljes së pavarësisë së Kosovës, ka qenë dhe mbetet partnere e rëndësishme e Republikës së Kosovës dhe shtyllë e projektit për integrimin evropian të vendit tonë. Jam i kënaqur se sot, së bashku me ministrin e Financave, Muratin, përfaqësuesin e Agjencisë Franceze për Zhvillim dhe me mikun tim, Benjamin, nënshkruam këto pesë marrëveshje të rëndësishme, së bashku edhe me letren e qëllimit. Kjo tregon se Franca dhe Kosova, përmes këtyre marrëveshjeve, po e ngrenë në një dimension krejt të ri marrëdhënien e tyre dypalëshe. Sot zhvilluam një takim të frytshëm, ku diskutuam për forcimin e marrëdhënieve tona dypalëshe, bashkëpunimin

ekonomik, çështjet e sigurisë dhe zhvillimet e tjera në rajonin tonë. Shprehja mirënjohjen tonë për mbështetjen e vazhdueshme të Francës ndaj Kosovës, përfshirë edhe ndihmën që Franca është e gatshme ta japë për organizimin e Lojërave Mesdhetare 2030. Ky është një kontribut që shkon përtej mbështetjes praktike. Ajo është shprehje e angazhimit të dy vendeve tona dhe e besimit të Francës, si fuqi qendrore në Bashkimin Evropian, por edhe si vend mesdhetar, në potencialin dhe të ardhmen e Kosovës. Kjo u jep Lojërat Mesdhetare 2030 një dimension të ri”, ka thënë ai, duke dhënë hollësi të tjera nga ky takim. “Diskutuam, po ashtu, për perspektivën evropiane të Kosovës. Republika e Kosovës ka dëshmuar përkushtimin e palëkundur ndaj reformave demokratike, sundimit të ligjit dhe përafrimit të politikave të saj të jashtme dhe të sigurisë me

Bashkimin Evropian. Në një kohë kur Evropa përballët me sfida të mëdha të sigurisë, besueshmëria e projektit evropian varet nga një zgjerim më i shpejtë, i drejtë dhe i bazuar në merita. Kosova ka bërë zgjedhjen e saj strategjike dhe zgjedhja jonë është Evropa, Bashkimi Evropian”, ka deklaruar Konjufca.

Ndërsa ministri i Deleguar për Evropën i Francës, Benjamin Haddad, ka thënë se është mik i Kosovës dhe ka bërë me dije se ka sjellë disa kompani franceze në Kosovë për të bashkëpunuar. “Jam i lumtur që gjatë viteve të fundit kemi punuar për t’i forcuar marrëdhëniet tona dypalëshe. Vizita ime sot u jep një shtysë të re këtyre marrëdhënieve. Më gëzon fakti që kemi nënshkruar pesë marrëveshje gjithëpërfshirëse, të cilat synojnë të avancojnë një agjendë pozitive në marrëdhëniet mes dy vendeve tona. Këto marrëveshje janë konkrete dhe krijojnë perspektivë për bashkëpunim afatgjatë, siç diskutuam edhe në takimin tonë, duke hapur rrugën për thellimin e mëtejshëm të marrëdhënieve. Me mua kanë ardhur edhe disa kompani franceze dhe Agjencia Franceze për Zhvillim (AFD), sepse ato besojnë në bashkëpunimin që mund të ndërtojmë së bashku. Mund t’i forcojmë marrëdhëniet tona tregtare, investimet franceze në Kosovë dhe të krijojmë më shumë mundësi biznesi mes dy vendeve

tona. Mbështetja që Agjencia Franceze për Zhvillim (AFD) i jep Kosovës është tashmë e konsiderueshme: 80 milionë euro për tranzicionin energjetik dhe luftën kundër ndryshimeve klimatike. Sapo kemi nënshkruar edhe një kredi prej 60 milionë eurosh për rinovimin e kompleksit të banimit të studentëve, i cili do të shërbejë si Fshati Olimpik për Lojërat Mesdhetare. Projekti do të përfshijë gjithashtu investime në objektet sportive dhe në shkollat përreth Qendrës Studentore. Ky është një investim që do të sjellë përfitime shumë përtej Lojërave Mesdhetare të vitit 2030”, ka deklaruar Haddad.

Pas Konjufcës, ministri francez Benjamin Haddad është takuar edhe me kryeministrin në detyrë, Albin Kurti.

Franca mbështet Kosovën për anëtarësim në Këshillin e Evropës, Haddad: Do të punojmë që kjo të ndodhë sa më shpejt

Ministri i Deleguar për Evropën i Francës, Benjamin Haddad, ka shprehur mbështetjen e vazhdueshme të Parisit për Kosovën, duke theksuar se Franca do të punojë që Kosova të anëtarësohet sa më shpejt në Këshillin e Evropës. Haddad ka

KONJUFCA: SPECIALJA TË MOS MARRË VENDIM POLITIK. DO TË ISHIM SHUMË TË REVOLTUAR NËSE LIDERËT E UÇK-së DO TË DËNOHESHIN

PRISHTINË, 27 KORRIK - Ministri në detyrë i Punëve të Jashtme i Kosovës, Glauk Konjufca, i ka bërë thirrje Gjykatës Speciale në Hagë që “të mos marrë vendim politik” kur më 16 shtator do ta shpallë aktgjykimin në rastin e krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK).

Pasi ka pritur ministrin e deleguar për Evropën të Francës, Benjamin Haddad, Konjufca është pyetur se cili do të ishte qëndrimi i institucioneve të Kosovës nëse Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi e Jakup Krasniqi do të dënoheshin. “Unë bëj thirrje që Gjykata e Hagës të mos marrë vendim politik, por të marrë vendim të drejtësisë. E

nëse merr vendim të drejtësisë, ne të gjithë e dimë çka është drejtësi, sepse ne jemi dëshmitarë si popull, që lufta e UÇK-së ka qenë e drejtë. Po të kishte qenë luftë kriminale, kurrë, kurrë nuk do ta kishte marrë mbështetjen e bashkësisë ndërkombëtare. Këtë mbajeni mend”, ka thënë ai.

Konjufca ka thënë se “nuk ka mundësi një luftë kriminale të mbështetet prej Shteteve të Bashkuara të Amerikës, prej Britanisë së Madhe, prej Gjermanisë e prej Francës”.

“Gjeneralët më të njohur të NATO-s kanë qenë afër me figurat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Oficerët e NATO-s kanë bashkëpunuar në trajnimin e



oficerëve të UÇK-së që lufta të jetë e suksesshme. Pse e kanë bërë këtë? Sepse ushtria jonë i ka kontribuar ndaljes së gjenocidit

të Millosheviqit. Ky është kuptimi i luftës së UÇK-së. E të gjithë të akuzuarit në Hagë i kanë kontribuar këtij qëllimi.

Kjo është drejtësia. Nëse vendoset me drejtësi, vendoset kështu”, ka thënë ai.

Konjufca ka thënë se populli i Kosovës do të ishte “shumë i revoltuar” nëse vendimi “nuk është me drejtësi”. “E ne nuk dëshirojmë si popull... bile do të ishim shumë të revoltuar, shumë të revoltuar, nëse vendimi nuk është me drejtësi, por është vendim politik”.

Trupi Gjykses i Gjykatës Speciale në Hagë ka vendosur në fillim të këtij muaji që ta shtyjë përfundimisht shpalljen e aktgjykimit në çështjen gjyqësore ndaj katër ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, më 16 shtator, si datën për ta kumtuar vendimin.

KUVENDI I JASHTËZAKONSHËM I LDK-së MBAHET TË ENJTEN

PRISHTINË, 27 KORRIK - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, e ka thirrur për të enjten, në orën 18:00, Kuvendin e Jashtëzakonshëm të partisë, në të cilin pritet të testohet besimi brendapartiak ndaj tij. LDK-ja ka lëshuar një komunikatë për medie, duke njoftuar opinionin publik dhe anëtarësinë, se Abdixhiku, “në ushtrim të kompetencave dhe detyrimeve të përcaktuara me Statutin e partisë, ka marrë vendim për thirrjen e Kuvendit të Jashtëzakonshëm të Lidhjes Demokratike të Kosovës, pas përfundimit të procedurave statutare të verifikimit të kërkesës së paraqitur nga delegatët e Kuvendit”. “Në funksion të garantimit të



rregullsisë, ligjshmërisë dhe integritetit të procesit, Sekretariati i Përgjithshëm i LDK-së ka kryer verifikimin e të gjitha nënshkrimeve të dorëzuara në përputhje me

dispozitat e Statutit. Nga ky proces është konstatuar se është përmbushur kriteri statutar prej së paku një të tretës (1/3) të delegatëve të Kuvendit, të nevojshëm për thirrjen e

Kuvendit të Jashtëzakonshëm. Në zbatim të detyrimeve statutare dhe pa asnjë vonesë pas përfundimit të procesit të verifikimit, kryetari i LDK-së ka vendosur që Kuvendi i Jashtëzakonshëm të mbahet të enjten, më 30 korrik 2026, me fillim nga ora 18:00”, është thënë në komunikatën e LDK-së.

Vendi i mbajtjes së Kuvendit dhe hollësitë e tjera organizative do t’u komunikohen delegatëve në përputhje me procedurat e përcaktuara nga Statuti, ka njoftuar LDK-ja. LDK-ja ka deklaruar se “mbetet e përkushtuar që i gjithë ky proces të zhvillohet në përputhje të plotë me Statutin e partisë, me parimet demokratike, transparencën institucionale dhe respektimin e vullnetit të

delegatëve të Kuvendit”.

Në selinë qendrore të LDK-së paraprakisht janë pranuar dhe verifikuar nënshkrimet e rreth 150 delegatëve të LDK-së të cilët kërkojnë shkarkimin e kryetarit të partisë.

Për shkak të kësaj nisme, Abdixhiku i ka pezulluar bisedimet me Lëvizjen Vetëvendosje për formimin e institucioneve të reja. Abdixhiku ka paralajmëruar se ky proces mund ta dëmtojë LDK-në “pariparueshëm nga brenda dhe ta lë Kosovën pa institucione dhe potencialisht përballë zgjedhjeve të reja në vjeshtë”, ndërsa kundërshtarët e tij brenda partisë kërkojnë përgjegjësi nga ai për rezultatit e dobët zgjedhor. Kuvendi i LDK-së i ka 355 delegatë, përfshirë kryetarin.



deklaruar se vizita e tij në Prishtinë është dëshmi e miqësisë së kahershme mes dy vendeve dhe synon forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve dypalëshe. “Kam kënaqësinë që jam sot në Prishtinë si mik personal i Kosovës

dhe si përfaqësues i presidentit Emmanuel Macron. Përtej miqësisë sonë, marrëdhëniet mes Francës dhe Kosovës janë të kahershme. Mbështetja jonë ka qenë gjithmonë e qëndrueshme dhe unë e konsideroj veten mik të

Kosovës prej shumë vitesh”, ka deklaruar Haddad.

Ai ka theksuar se Franca është e gatshme ta mbështesë Kosovën edhe financiarisht në fusha të ndryshme me qëllim forcimin e bashkëpunimit mes dy vendeve.

“Jemi të gatshëm që ta përkrahim financiarisht Kosovën edhe në fusha të tjera”, është shprehur ministri francez. Duke folur për proceset integruese të Kosovës, Haddad ka deklaruar se gjatë takimeve me zyrtarët kosovarë

është diskutuar edhe për anëtarësimin e vendit në Këshillin e Evropës. “Do të punojmë së bashku që Kosova të anëtarësohet sa më shpejt në Këshillin e Evropës”, ka deklaruar Haddad.

Formimi i institucioneve, Konjufca: Ka gatishmëri nga LDK-ja, kurse PDK-ja dha qëndrime të vjetra

Zëvendësministri në detyrë, Glauk Konjufca, ka folur lidhur me procesin e formimit të institucioneve të reja të Kosovës. Gjatë një konference për medie, Konjufca ka deklaruar se gjatë takimeve me PDK-në, sipas tij, janë shprehur qëndrime të vjetra, të cilat janë parë edhe më herët. Ndërsa sa i përket LDK-së, Konjufca ka deklaruar se këndvështrimi i LV-së është se kjo parti ka vullnet më të madh për ta tejkaluar situatën në të cilën ndodhet Kosova. “Ka gatishmëri

më të lartë nga LDK-ja dhe mendoj që opsionet që dalin në tavolinë për arritjen e një marrëveshjeje janë në përpjesëtim me vullnetin. Sa më i madh vullneti politik, sa më e madhe gatishmëria për bashkëpunim, aq më shumë rritet numri i opsioneve për të gjetur zgjidhje për përgjegjësitë e ndryshme, se si ndahet ajo”, ka deklaruar Konjufca.

Ai, po ashtu, ka theksuar se tashmë mbetet të shihet zhvillimi i brendshëm në LDK.

Hapet aplikimi për subvencionimin e teksteve dhe materialeve shkollore

PRISHTINË, 27 KORRIK - Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) ka njoftuar se është hapur aplikimi për subvencionimin e teksteve dhe materialeve shkollore për nxënësit e arsimit fillor të ulët dhe të mesëm të ulët (klasat 1-9). Aplikimi do të bëhet përmes platformës “eKosova” dhe do të jetë i hapur për një periudhë

prej dy javësh, nga 27 korriku deri më 9 gusht 2026. Subvencionimi përfshin blerjen e teksteve dhe materialeve shkollore për nxënësit e arsimit fillor të ulët dhe të mesëm të ulët (klasat 1-9). Mjetet financiare do të transferohen drejtpërdrejt në xhirollogarinë bankare të prindit ose aplikuesit. “Para se të aplikoni,

ju lutemi sigurohuni që xhirollogaria juaj bankare është aktive dhe e saktë, si dhe që të dhënat tuaja në ‘eKosova’ janë të përditësuara. Aplikimi do t’u mundësohet edhe shtetasve të huaj me leje qëndrimi të përkohshme ose të përhershme në Republikën e Kosovës, fëmijët e të cilëve vijnë në mësimin në institucionet

arsimore të Republikës së Kosovës”, ka njoftuar MASH-i. Për shtetasit e huaj që ende nuk kanë leje qëndrimi, por kanë fëmijë të regjistruar në shkollat e Republikës së Kosovës, MASH-i do t’ia dorëzojë ASH-i-së listën e këtyre rasteve, me qëllim të krijimit të qasjes në “eKosova” për aplikim. Dokumentet për këtë kategori



do të dorëzohen përmes emailit në adresën: libri@rks-gov.net.

PËRNDJEKJA E ÇLIRIMTARËVE



Shkruan: Prof. Agim R. ZOGAJ

Persekutimi i qëllimshëm i komandantëve të UÇK-së

Kaluan plot 27 vjet nga çlirimi i Kosovës, nga lufta heroike e popullit tonë nën udhëheqjen e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ndërkohë, sikur në Gjykatën Speciale në Hagë, ashtu edhe në gjykatat e shtetit të Kosovës, vazhdojnë gjykimet e padrejta, të inskenuara, qëllimkeqe ndaj çlirimtarëve, ndaj ish-komandantëve të UÇK-së, ndaj atyre të cilët janë meritore për shtetndërtimin e Kosovës, për zhvillimin e komunave, ndër të cilat është edhe komuna e Skenderajt! Të gjitha rastet e përndjekjes së shpifur kundër çlirimtarëve janë shkelje e lirisë dhe e drejtave të njeriut, në rastet konkrete, me aktakuza të fabrikuara nga EULEX-i, i cili kurrnjëherë nuk u mor me protagonistët e gjenocidit të Serbisë ndaj popullit shqiptar në Kosovë, por me luftën çlirimtare të popullit tonë, me çlirimtarët! Përkundrazi, EULEX-i që nga vendosja e tij në Republikën e Kosovës instaloi politikat e

përndjekjes, në stilin e gjykatave serbe, kundër çlirimtarëve tanë, kundër atyre personaliteteve të cilët ishin në ballë të luftës sonë çlirimtare nga sundimi serb, ishin protagonistë, prijës të luftës çlirimtare, luftës kundër pushtuesit, agresorit serb! Ditë më parë Gjykata Themelore në Prishtinë, pikërisht me një aktakuzë të stërvjetëruar, të improvizuar, të llojit të atyre të EULEX-it, sërish, për të satën herë, e trajtoi, rastin e padrejtë, të shpifur ndaj njërit nga çlirimtarët, Sami Lushtakun! Sami Lushtaku, dje, ish-komandant trim i UÇK-së, një ndër bashkëluftëtarët e kryetrimt, Adem Jashari, sot, një ndër kryetarët më të respektuar, të suksesshëm të komunave të Kosovës, Skenderajt, në mbrojtjen e tij, ndër të tjera, tha se: “... që 13 vjet persekutohem nga EULEX-i, pa argumente dhe pa fakte... Unë e ndiej veten që 13 vjet i penalizuar dhe i përndjekur nga Gjykata e EULEX-it! Asnjë gjykatë vendore, jo vetëm në rastin përkatës, Gjykata Themelore në Prishtinë, nuk mund të ketë justifikim të argumentuar, përse, mbi shpifjet,

montimet e EULEX-it, vazhdon ta persekutojë qytetarin e lirë, kryetarin e komunës së Skenderajt, ish-komandantin e UÇK-së, personin i cili ka kontribut të përditshëm në shtetndërtimin e Republikës së Kosovës, të institucioneve tona demokratike, z. Sami Lushtakun! Vendimi i vetëm dhe i drejtë, juridikisht, i Gjykatës Themelore në Prishtinë duhet të jetë vendimi për shpalljen e pafajësisë e z. Sami Lushtaku! Kjo, aq më parë, sepse aktakuza aktuale e Gjykatës Themelore në Prishtinë, siç e tha vetë Sami Lushtaku “... iu ka mvëshur Gjykatës themelore në Prishtinë si dëshmi e hekurt nga EULEX-i...!”.

Drejtësia për çlirimtarët do të triumfojë

Në rastin përkatës, dhe në cilindo rast tjetër, gjykatat e Republikës së Kosovës nuk duhet të ndikohen nga cilado aktakuzë mashtruese apo nga vendime gjyqësore tendencioze, të qëllimshme të EULEX-it, të Serbisë. Duhet të përfundojë ajo

histori e padrejtë, që çlirimtarët të përndiqen me dekada, sipas aktakuzave të fabrikuara, pa fakte, pa prova, me montime nga gjykatat e EULEX-it! Fjala është, nga ato vendime gjyqësore të EULEX-it, të cilat asnjëherë nuk kanë pasur bazë juridike, përkundrazi, kishin qëllime politike, kundër UÇK-së, de facto ishin, përpjekje për ekuilibrim mashtrues midis luftës çlirimtare të popullit të Kosovës dhe luftës pushtuese, gjenocidit të shtetit serb kundër popullit tonë. Ky mashtrim i madh, në të cilin ka hise edhe vetë EULEX-i, gjithsesi edhe Serbia, ka ndodhur edhe me rastin e ngritjes së aktakuzës shpifëse të Gjykatës Speciale kundër çlirimtarëve tanë. Ndaj është koha, është çasti i të vërtetës së vetme, lidhur me përndjekjet e çlirimtarëve tanë, shpallja e pafajësisë së tyre, duke u nisur nga Gjykata Themelore në Prishtinë e deri te Gjykata Speciale në Hagë! Sami Lushtaku, me të drejtë, me vetëbesim, i argumentuar, në foltoren e Gjykatës Themelore në Prishtinë tha: “Kam kërkuar vetëm drejtësi!”. Sami Lushtakun, çlirimtarët e

syrigjynosur, pa të drejtë, në paraburgim në Hagë, i mbron lufta çlirimtare e popullit, e UÇK-së, i mbron, çlirimi, liria e Kosovës, themelimi i shtetit të pavarur, Republikës së Kosovës! Gjykatat tona, të Republikës së Kosovës, përfundimisht duhet ta mbyllin kapitullin kur ngrehin aktakuza, edhe me pamfletet, me inskenime tendencioze, që mbajnë aromë antishqiptare, anti-UÇK, me shenjat e EULEX-it, apo edhe të propagandës, të trillimeve që vijnë nga Serbia çentike! Ndërsa sa i përket EULEX-it, Gjykatës Speciale në Hagë, BE-së, por edhe Gjykatës Themelore në Prishtinë, ju sugjerojmë të merren me deklaratën e sotme, të presidentit serbomad, antishqiptarit të Serbisë, Vuçiq, i cili, në ceremoninë e përmirimit të gjeneratës më të re të oficerëve të Ushtrisë së Serbisë, tha: “Kosova është pjesë e Atdheut tonë, pjesë e Serbisë sipas Kushtetutës dhe sipas drejtësisë së Zotit?! Për çdo heshtje ndaj kërcënimeve fashiste, hegjemoniste të Serbisë, BE-ja merr vetëpërgjegjësi jo vetëm morale!

Oficeri i FSK-së, Kushtrim Fazliu, përfundon me sukses kursin ushtarak në ShBA

PRISHTINË, 27 KORRIK - Nëntoger Kushtrim Fazliu ka përfunduar me sukses Kursin e Inxhinierisë Ushtarake EBOLC (Engineer Basic Officer Leader Course), i cili është një program i avancuar profesional i Ushtrisë së Shteteve

të Bashkuara. Sipas njoftimit të FSK-së, ky kurs synon zhvillimin e aftësive udhëheqëse, taktike dhe teknike të oficerëve të inxhinierisë ushtarake. Gjatë kursit, pjesëmarrësit aftësohen në planifikimin dhe

zbatimin e operacioneve të inxhinierisë luftarake, ndërtimin e kapaciteteve mbështetëse dhe komandimin efektiv të njësisë në mjedise komplekse operationale. “Nëntoger Fazliu, për shkak të performancës së dalluar gjatë

kursit, është vlerësuar me dy çmime: Distinguished Honor Graduate, si oficeri ndërkombëtar me performancë më të lartë akademike, si dhe Iron Man Award, për performancën e lartë fizike”, ka njoftuar FSK-ja.



SULMI NË “IBËR-LEPENC” SHKAKTOI MBI 376 MIJË EURO DËME

PRISHTINË, 27 KORRIK - Drejtori i Departamentit të Ujit dhe Gjenerimit në ndërmarrjen “Ibër-Lepenc”, Ernest Kërqeli, ka deklaruar se sulmi në kanalën e “Ibër-Lepencit” në Zubin Potok, më 29 nëntor 2024, ka shkaktuar dëme në vlerë prej mbi 376 mijë eurosh, ndërsa furnizimi me ujë për ujësjellësit ishte ndërprerë për tre deri në pesë ditë. Duke iu përgjigjur pyetjeve të prokurorisë, Kërqeli, i cili në këtë rast është edhe dëshmitar, ka thënë se pas njoftimit për shpërthimin, ekipet e ndërmarrjes kishin ndërmarrë masa për sanimin e dëmit dhe për të siguruar vazhdimin e rrjedhës së ujit drejt Termocentralit “Kosova B”. “Pas njoftimit kemi marrë informacion edhe nga Policia e Kosovës dhe të gjitha ekipet që kemi pasur në dispozicion i kemi nisur në atë pjesë. Pas një kohe të shkurtër kam mbërritur nga Gjilani me një koleg në vendngjarje dhe kemi parë që dëmi ishte jashtëzakonisht i madh. Ne, si ndërmarrje, nuk jemi ballafaquar asnjëherë me një dëm të tillë. Fatmirësisht, kemi pasur ekupe me makineri të rënda që kanë qenë duke punuar në Zubin Potok. I kemi thirrur ekipet dhe kemi filluar të mendojmë për sanimin e dëmit, në mënyrë që uji të mos ndalej në rrjedhën e poshtme të kanalit. Pasi kemi marrë leje nga policia, kemi ndërmarrë masa që në atë pjesë të dëmtuar të kanalit të vendosim një zgjidhje të përkohshme, meqenëse dëmi ka qenë i madh. Zgjidhja që kemi bërë atë ditë nuk ka qenë 100 për qind funksionale, edhe pse kemi vendosur gjashtë gypa me diametër mbi 900 milimetra, në mënyrë që uji të vazhdojë rrjedhën dhe të mos ndërpritet furnizimi për Termocentralin ‘Kosova B’”, ka deklaruar Kërqeli. Drejtori i “Ibër-Lepencit” ka



theksuar rëndësinë e kanalit për furnizimin me ujë dhe prodhimin e energjisë elektrike në Kosovë. “Edhe në cilësinë e drejtorit të ‘Ibër-Lepencit’, edhe në cilësinë time si inxhinier, kanali është arteria kryesore, pa të cilin Kosova nuk mund të funksionojë në aspektin energjetik dhe të furnizimit me ujë. Ky ujë, i cili vjen nga liqeni i Ujmanit dhe përfundon në pikën ku furnizohet ‘Kosova B’, është i nevojshëm për ftohjen e turbinave të termocentralit ‘Kosova B’. Me një fjalë, pa ujë, ne si Kosovë nuk mund të prodhojmë energji elektrike. Thuajse gjysma e Kosovës, mbi 500 mijë banorë, furnizohen me ujë nga kanali i ‘Ibër-Lepencit’”, ka deklaruar ai. Kërqeli ka treguar se pas sulmit, ndërmarrja kishte arritur që gjatë natës ta rikthente furnizimin në 75 për qind të kapacitetit të rregullt. “Ne kemi arritur që në natën kritike ta kthejmë

furnizimin vetëm në 75 për qind të kapacitetit të rregullt. Rreth orës 02:00 kemi arritur ta funksionalizojmë zgjidhjen e parë. Pas kësaj, kjo zgjidhje nuk ka qenë funksionale për shkak të dëmit në atë pjesë, ndaj kemi vazhduar me zgjidhjen tjetër. Furnizimi për ujësjellësit ka qenë i ndërprerë për tre deri në pesë ditë, ndërsa edhe pas pesë ditësh ujësjellësit nuk kanë mundur të furnizohen me kapacitete të plota”, ka deklaruar Kërqeli. Kërqeli ka bërë me dije se dëmi është sanuar përmes një projekti të financuar për rehabilitimin e kanalit, ndërsa vlera e dëmit të shkaktuar, sipas tij, është mbi 376 mijë euro. “Dëmin e shkaktuar e kemi sanuar nëpërmjet një projekti i cili kishte qenë paraprakisht duke u zhvilluar, i financuar përmes një kredie të marrë nga Banka Botërore për rehabilitimin e kanalit. Me këtë projekt e kemi sanuar dëmin që na është

shkaktuar. Raporti është përpiluar nga kompania konsulente që kemi angazhuar për mbikëqyrje dhe i është dorëzuar edhe Bankës Botërore. Dëmi është mbi 376 mijë euro”, ka deklaruar ai. I pyetur nëse i ka parë apo takuar të pandehurit, Kërqeli ka deklaruar se nuk i njeh. Sulmi në kanalën e “Ibër-Lepencit” kishte ndodhur më 29 nëntor 2024 në fshatin Varagë të Zubin Potokut. Pak më shumë se një vit pas sulmit, Prokuroria Speciale, pas një hetimi të zhvilluar në bashkëpunim me Policinë e Kosovës – Drejtorinë Kundër Terrorizmit dhe partnerët evropianë, ka ngritur aktakuzë ndaj vëllezërve Jovan Viqentijeviq dhe Dragisha Viqentijeviq, si dhe Igor Dimoviqit, për veprat penale “Rrezikimi i rendit kushtetues me shkatërrimin apo dëmtimin e instalimeve dhe pajisjeve publike”, në lidhje me veprën

penale “Kryerja e veprës terroriste”, “Armëmbajtje pa leje” dhe “Spiunazh”. Sipas aktakuzës, më 29 nëntor 2024 në fshatin Varagë të komunës së Zubin Potokut, në pjesën e kanalit “Ibër-Lepenc”, të pandehurit Viqentijeviq, së bashku me disa persona të tjerë ende të panjohur, pas një marrëveshjeje paraprake, kanë vendosur eksploziv, rreth 20 kilogramë të llojit trinitrotoluen (TNT), në brendësi të kanalit. Vëllezërit Viqentijeviq akuzohen se lëndën shpërthyesë e kanë aktivizuar përmes një çante të cilën e kishin lidhur me litar në një shtyllë betoni. Si pasojë, është dëmtuar rëndë struktura e betonit të kanalit “Ibër-Lepenc”, është shkaktuar ndërprerje e furnizimit me ujë të pijshëm, është rrezikuar prodhimi i energjisë elektrike dhe ndërmarrjes “Ibër-Lepenc” i është shkaktuar dëm në vlerë prej 376 774.70 eurosh.

AKTAKUZË NDAJ DREJTORIT KOMUNAL DHE NJË OPERATORI EKONOMIK NË SUHAREKË

PRIZREN, 27 KORRIK - Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurit B. B. për shkak të dyshimit të bazuar mirë se ka kryer veprën penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 414, par. 1 i KPRK-së, dhe A.M., për shkak të dyshimit të bazuar mirë se i njëjti ka kryer veprën penale “Keqpërdorimi apo mashtrimi në prokurim publik” nga neni 415, par. 2, lidhur me par. 1 sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK). Sipas aktakuzës, i pandehuri B. B., drejtor i Kulturës, Rinisë dhe Sportit në komunën e Suharekës, prej datës 23 shtator 2019 deri më 20 dhjetor 2021 në cilësinë e menaxherit të kontratës në projektin “Ndërtimi



i lapidarit për viktimat e viteve (1912-1945)” në fshatin Samadraxhë, duke shfrytëzuar detyrën dhe autoritetin zyrtar, me dashje ka tejkaluar kompetencat e tij, me qëllim që

t’i mundësojë përfitim operatorit ekonomik “A.G.” Sh.P.K. Sipas aktakuzës, ai, në kuadër të kontratës në vlerë të përgjithshme prej 28,650.00

eurosh, për realizimin e projektit të lartcekur, ka nënshkruar pagesën në vlerë prej 5,000 eurosh sipas situacionit të katërt të kontratës, duke konstatuar se punimet ishin realizuar sipas paramasës dhe parallogarisë, ndonëse në terren ato nuk ishin kryer në përputhje me kontratën dhe nuk ishte paraqitur asnjë kërkesë për kolaudim apo për ndryshim të punimeve. Me këto veprime, komunës së Suharekës i është shkaktuar dëm material në shumën prej 5,000 eurosh, i cili është vërtetuar edhe me ekspertizën e ndërtimtarisë. Ndërkaq, i pandehuri A. M., në cilësinë e personit përgjegjës të operatorit ekonomik “A.G.” Sh.P.K., me dashje nuk ka zbatuar detyrimet që rrjedhin nga kontrata e prokurimit publik për realizimin e projektit

“Ndërtimi i lapidarit për viktimat e viteve (1912-1945)” në fshatin Samadraxhë, ai ka pranuar pagesën në shumën prej 5 000 eurosh sipas situacionit të katërt të kontratës, ndonëse punimet e parapara nuk ishin realizuar sipas kontratës dhe specifikimeve teknike, duke përfituar mjete publike në mënyrë të kundërligjshme dhe duke i shkaktuar komunës së Suharekës dëm material. Prokurori i çështjes, me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, administrimit dhe vlerësimit të provave, të pandehurit e lartcekur, për veprat penale për të cilat akuzohen, të shpallen fajtorë dhe të dënohen sipas ligjit.

ÇFARË FSHIHET PAS FORCIMIT REKORD TË LEKUT?



TIRANË, 27 KORRIK - Një euro u këmbye këtë javë me vetëm 93.62 lekë, niveli më i ulët historik kundrejt monedhës shqiptare. Në teori, një lek më i fortë do të duhej t'i bënte më të lira mallrat e importuara, t'i ulte kostot për bizneset dhe ta rriste fuqinë blerëse të qytetarëve.

Por, në Shqipëri ndodh e kundërta. Çmimet e ushqimeve vazhdojnë të mbeten ndër më të lartat në rajon, eksportuesit ankohen se po humbasin konkurrueshmërinë, ndërsa ekonomistët vënë në pikëpyetje nëse shpjegimet zyrtare mjaftojnë për të kuptuar pse leku është forcuar aq shumë.

Debati është shndërruar në një përplasje mes qeverisë, opozitës dhe ekspertëve të ekonomisë. Qeveria ka argumentuar se forcimi i lekut është rezultat i hyrjes së sasive të mëdha të valutës në ekonomi, të nxitura nga turizmi, investimet e huaja dhe remitencat. Opozita, në anën tjetër, pretendon se kursi i këmbimit ndikohet edhe nga ekonomia joformale dhe pastrimi i parave. Ndërsa një pjesë e ekonomistëve thonë se të dhënat zyrtare nuk e shpjegojnë plotësisht këtë fenomen dhe kërkojnë një analizë më të thellë të burimeve të valutës që hyn në vend.

Për kryeministrin Edi Rama nuk është euroja ajo që është dobësuar, por leku që është forcuar. “Forcimi i lekut është sukses për ekonominë shqiptare. Është tregues kokëfortë i rritjes së ekonomisë”, ka deklaruar ai ditët e fundit, duke e lidhur këtë zhvillim kryesisht me rritjen e të ardhurave nga turizmi.

Shifrat zyrtare e mbështesin këtë argument. Sipas Bankës së Shqipërisë, vizitorët e huaj shpenzuan rreth 5.7 miliardë euro në Shqipëri gjatë vitit 2025, rreth 15 për qind më shumë se një vit më parë.

Ministria e Financave e Shqipërisë ka raportuar, gjithashtu, 1.6 miliard euro

investime të huaja direkte dhe mbi 2 miliardë euro remitenca, të cilat, sipas qeverisë, kanë rritur ndjeshëm ofertën e euros në treg dhe kanë çuar në forcimin e lekut. Por, opozita ka thënë se një monedhë më e fortë nuk është domosdoshmërisht shenjë e një ekonomie më të fortë, duke argumentuar se ky zhvillim nuk është shoqëruar me rritje të prodhimit, produktivitetit apo eksporteve. Sipas saj, forcimi i lekut nuk reflekton gjendjen reale të ekonomisë shqiptare.

A mjaftojnë turizmi, investimet dhe remitencat për ta shpjeguar? Për qeverinë, përgjigjja është po. Kryeministri Rama hedh poshtë pretendimet se pas forcimit të lekut fshihen kryesisht para me origjinë të dyshimtë. Sipas tij, hyrja e madhe e valutës në ekonomi është rezultat i zhvillimeve të ligjshme, mbi të gjitha, i bumit të turizmit.

“Diskutojmë që këtu ka një lavatriçe parash të pista, por kush do të na linte ne të vazhdonim të mbyllnim kapitujt me Bashkimin Evropian?”, ka thënë Rama, duke shtuar se zbulimi i rasteve të pastrimit të parave tregon forcimin e institucioneve dhe jo se Shqipëria është një “narkoshtet”.

Opozita e sheh ndryshe situatën. Kreu i Partisë Demokratike, Sali Berisha, ka pretenduar se mbiçmimi i lekut nuk mund të shpjegohet vetëm me turizmin apo investimet, por lidhet edhe me hyrjen e parave nga aktivitetet kriminale. Edhe pse nuk paraqet prova konkrete për këtë pretendim, ai ka argumentuar se flukset e mëdha të euros kanë ndikuar në kursin e këmbimit, pa sjellë përmirësim të mirëqenies së qytetarëve apo të ekonomisë prodhuese.

Debati nuk është i ri. Prej vitesh, ekonomia joformale dhe rreziku i pastrimit të parave kanë qenë pjesë e diskutimeve për ekonominë shqiptare. Raporti i fundit i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit

të Organizuar (SPAK) tregon se vetëm gjatë vitit 2025 janë sekuestruar dhe konfiskuar rreth 45.4 milionë euro pasuri, ndërsa sektori i ndërtimit dhe pasuritë e paluajtshme identifikohen si ndër fushat me ekspozimin më të lartë ndaj pastrimit të parave. Megjithatë, vetë këto të dhëna nuk provojnë se kursi i këmbimit është ndikuar nga aktivitetet kriminale.

Pikërisht për këtë arsye, disa ekonomistë argumentojnë se debati nuk duhet të mbështetet vetëm te deklaratat politike, por te analiza e treguesve ekonomikë.

Sipas tyre, pyetja kryesore nuk është nëse turizmi ka sjellë më shumë euro në Shqipëri, kjo është e padiskutueshme, por nëse kjo mjafton për të shpjeguar një forcim kaq të madh të lekut.

Ekonomistët: Shifrat nuk e shpjegojnë plotësisht forcimin e lekut

Irena Beqiraj, ish-zëvendësministre e Financave e Shqipërisë, argumenton se analiza e Qeverisë mbështetet vetëm te paratë që hyjnë në vend, por nuk merr parasysh edhe ato që dalin. Sipas saj, nga rreth 5.7 miliardë euro të ardhura nga turizmi gjatë vitit 2025 duhet të zbriten rreth 3.06 miliardë euro që shqiptarët shpenzuan jashtë vendit.

Edhe te investimet e huaja, ajo sheh një dallim të rëndësishëm. Një pjesë e madhe e tyre, ka thënë Beqiraj, nuk paraqet kapital të ri që ka hyrë në Shqipëri, por fitime që kompanitë e huaja kanë zgjedhur t'i riinvestojnë në vend.

Ndërsa remitencat, sipas saj, janë rritur, por jo në nivele që do të shpjegonin një ndryshim kaq të madh të kursit të këmbimit. “Për mua, 25 deri në 40 për qind e mbiçmimit të lekut mbetet e pashpjeguar nga turizmi, investimet e huaja dhe remitencat”, ka thënë Beqiraj.

Qëndrim të ngjashëm ka edhe

ekonomisti Pano Soko. Ai ka argumentuar se, nëse forcimi i lekut do të ishte rezultat i ekonomisë reale, kjo do të reflektohej para së gjithash te bilanci tregtar. “... por, të dhënat tregojnë se bilanci është në deficit dhe diferenca mbetet thuajse e njëjtë që prej vitit 2013, kur euroja këmbuhej me 140 lekë. Nëse ky raport mes importit dhe eksportit nuk ka ndryshuar, edhe kursi i këmbimit do të mbetej i njëjtë”, ka thënë Soko për “Radion Evropa e Lirë”.

Sipas tij, as investimet e huaja nuk e shpjegojnë këtë zhvillim. “Nëse do të shihnim vetëm këtë tregues, euroja madje do të duhej të ishte forcuar, sepse investimet e huaja nga viti 2015 deri më sot kanë rënë”, ka thënë ai.

Atëherë, nga vjen pjesa tjetër e valutës që ushtron presion mbi kursin e këmbimit?

Beqiraj ka thënë se të dhënat zyrtare të ekonomisë nuk e shpjegojnë plotësisht forcimin e lekut dhe se kjo mund të nënkuptojë ekzistencën e flukseve të tjera valutore që nuk pasqyrohen në statistikat zyrtare. Soko shkon një hap më tej, duke argumentuar se ekonomia joformale dhe paratë me origjinë kriminale kanë një ndikim të rëndësishëm në tregun valutë, pasi për kursin e këmbimit rëndësi ka sasia e euros që hyn në qarkullim, pavarësisht burimit të saj.

Leku forcohet, por pse nuk ndihet në xhepin e qytetarëve?

Në teori, një monedhë më e fortë duhet të sjellë përfitime të prekshme për ekonominë. Importet bëhen më të lira, kostot e bizneseve ulen dhe kjo, me kalimin e kohës, duhet të reflektohet edhe në çmimet që paguajnë konsumatorët. Por, ekonomistët thonë se kjo nuk ka ndodhur në Shqipëri. Një studim i fundit mbi çmimet tregon se në

vitin 2024 çmimet e ushqimeve dhe pijeve joalkoolike në Shqipëri arritën në 100 për qind të mesatares së Bashkimit Evropian, nga 68 për qind sa ishin në vitin 2012. Sipas autorëve të studimit, Shqipëria ka regjistruar rritjen më të madhe të çmimeve të ushqimeve në rajon, ndonëse të ardhurat e familjeve shqiptare mbeten shumë më të ulëta se në vendet e BE-së. Azmi Stringa, një nga autorët e studimit, ka thënë se forcimi i lekut nuk është përkthyer në ulje çmimesh për konsumatorët. “Një lek më i fortë duhej të sillte përfitime për qytetarët dhe ekonominë prodhuese, por kjo nuk ka ndodhur”, ka thënë Stringa për “Radion Evropa e Lirë”.

Ai ka shtuar se problemet strukturore të ekonomisë shqiptare, si konkurrenca e dobët, mungesa e transparencës në treg dhe mbikëqyrja e kufizuar, kanë penguar që efekti pozitiv i kursit të këmbimit të arrijë te konsumatori.

Edhe Beqiraj i referohet të njëjtit studim për të ilustruar paradoksin. Sipas saj, çmimet e ushqimeve në Shqipëri janë tashmë të krahasueshme, madje në disa raste edhe më të larta se në vende si Holanda apo Spanja, megjithëse këto vende kanë të ardhura dhe nivel jetese dukshëm më të lartë. “Rezultatet e studimit tregojnë se çmimet e ushqimeve në Shqipëri janë rritur më herët, më shpejt dhe në mënyrë më frekvente se në vendet e rajonit, edhe pse leku është vlerësuar me rreth 30 për qind gjatë dekadës së fundit”, ka thënë Beqiraj.

Ndërkohë, një lek më i fortë nuk prek të gjithë njësoj. Ekonomistët kanë thënë se ndër më të goditurit janë eksportuesit, të cilët të ardhurat i sigurojnë në euro, ndërsa pagat, energjinë, qiratë dhe shumicën e kostove i paguajnë në lekë. Me zhvlerësimin e euros, fitimet e tyre tkurren dhe produktet shqiptare bëhen më pak konkurruese në tregjet ndërkombëtare. Sipas Sokos, të njëjtin presion e ndien edhe sektori i turizmit. “Turizmi i bën ofertat në euro dhe me rënien e saj do të detyrohet ta rrisë çmimin. Por, një çmim më i lartë nuk e bën atë konkurrues me vende të tjera. Nëse kjo rënie e euros vijon, shumë operatorë turistikë do të detyrohen të dalin nga tregu”, ka thënë Soko.

Përfitues, nga ana tjetër, janë ata që blejnë mallra jashtë vendit ose kanë detyrime financiare në euro. Bizneset importuese paguajnë më pak për produktet që sjellin nga jashtë, ndërsa qytetarët që kanë kredi në euro i shlyejnë ato me më pak lekë se disa vite më parë. Edhe shteti përfiton, pasi një pjesë e borxhit publik është marrë në euro dhe sot shlyhet me një kurs këmbimi më të favorshëm.

6 STRATEGJI. SI TA KESH GJITHMONË PËRGJIGJEN GATI



Nuk është e lehtë t'i përgjigjesh menjëherë një komenti therës me një kundërpërgjigje të zgjuar. Shpesh mbetemi pa fjalë dhe vetëm më vonë, fatkeqësisht shumë vonë, mendja na sjell përgjigjen që duhej të kishim dhënë në atë moment. Si mund të bëhemi më të zotë në këto situata? Sipas ekspertëve të komunikimit, ekzistojnë gjashtë strategji që mund të na ndihmojnë. Kjo u ndodh të gjithëve. Po debaton me një koleg, biseda nxehet dhe papritur ai të lëshon një batutë të hidhur ose një përgjigje brilante. Ti mbetesh pa fjalë, ndërsa ai buzëqesh triumfues. Pastaj, sapo mbërrin në shtëpi dhe e rikthen skenën në mendje, të vjen ndërmend një përgjigje po aq e zgjuar. Francezët e quajnë këtë fenomen esprit de l'escalier ("shpirti i shkallëve"), një shprehje që përshkruan momentin kur njeriu gjen përgjigjen e duhur vetëm pasi situata ka kaluar.

Shprehjen e krijoi filozofi Denis Diderot (1713–1784) në veprën Paradoksi mbi aktorin: "Një

njeri i ndjeshëm si unë, i tronditur nga argumenti i kundërshtarit, humbet fillin e mendimit dhe e gjen sërish vetëm kur ka zbritur shkallët." Në atë kohë sallonet ku zhvilloheshin pritjet ndodheshin zakonisht në katin e dytë dhe "të zbrisje shkallët" nënkuptonte se po largoheshe nga mbrëmja. Edhe filozofi tjetër francez, Jean-Jacques Rousseau, në veprën Rrëfimet, pranon se shpesh binte në këtë kurth dhe madje ia atribuonte këtij fenomeni famën e tij si njeri i tërhequr dhe i vështirë në marrëdhënie. Atëherë, si duhet të reagojmë përballë një komenti të papërshtatshëm ose një vërejtjeje fyese? Sipas ekspertes së komunikimit Barbara Berckhan, po. Ajo propozon gjashtë strategji që kanë rezultuar efektive gjatë studimeve të saj.

Strategji e parë: Kundërpëyetja

Kjo strategji konsiston në përgjigjen ndaj një komenti fyjes pa hyrë në konflikt me per-

sonin që e ka bërë. Në vend që të kundërshtosh, thjesht përsërit fjalët që të goditën dhe kërko një shpjegim. Shembull: Marta pyet Lukën si i rri një fustan i ri. Luka përgjigjet: "Të rri ngjitur pas trupit si lëkura e një sallami." Reagimi instinktiv i Martës mund të ishte ta ofendonte. Por, duke përdorur strategjinë e kundërpëyetjes, ajo mund të thotë: "Çfarë do të thuash me 'si lëkura e një sallami'?" Në këtë mënyrë mund të zbulohet se Luka nuk kishte për qëllim ta fyente, por thjesht po përdorte një krahasim të pazakonit. Kjo strategji i jep mundësi bashkëbiseduesit të sqarojë qëndrimin e tij dhe shmang përshkallëzimin e konfliktit. Berckhan paralajmëron: "Kjo nuk duhet të jetë një kundërpëyetje agresive, si: 'Çfarë deshe të thuash me këtë? Do të më acarosh?'" Përkundrazi, duhet bërë me qetësi dhe me interes të sinqertë për të kuptuar, duke ruajtur një qëndrim të qetë dhe jo armiqësor.

Strategji e dytë: Heshtja

Përballë një batute të pahijshme, ndonjëherë është shumë më mirë të mos reagosh fare. Kështu shmangen pasojat e pakëndshme dhe kundërshtari mbetet i çarmatosur. Siç thotë Berckhan: "Duke heshtur, e lëmë tjetrin vetëm me fjalët e veta, pa i dhënë kënaqësinë që të na shohë duke reaguar." Heshtja është një mjet i fuqishëm sepse tregon se kemi zgjedhur me vetëdije të mos i kushtojmë rëndësi komentit. Ajo bëhet edhe më efektive nëse shoqërohet me një gjest të papritur dhe të qetë. Për shembull: të tundësh kokën sikur po e përshëndet; të tregosh me gisht nga dritarja ose qielli, sikur po i tërheq vëmendjen për diçka tjetër. Në këtë mënyrë, personi që bëri komentin mbetet pa reagimin që priste dhe shpesh nuk di më si ta vazhdojë sulmin.

Strategji e tretë: Faza standarde

Një tjetër mënyrë është t'i përgjigjesh një komenti fyjes me

një frazë të zakonshme si: "Po mirë?" "Ah, po?" "Vërtet?" "E kuptoj."

Këto përgjigje përcjellin një indiferencë të plotë ndaj fjalëve të tjetrit. Pikërisht për këtë arsye, komentet fyese fillojnë të duken të pavlera dhe nuk meritojnë më vëmendje. Në këtë mënyrë, personi që kërkon të provokojë nuk arrin qëllimin e tij dhe kupton se fjalët e tij nuk kanë asnjë ndikim.

Strategji e katërt: Lavdërimi

Kjo strategji, shumë efektive nëse përdoret siç duhet, konsiston në t'i përgjigjurit ndaj një komenti arrogant me një kompliment ose një fjalë të sjellshme. Megjithatë, ka një kusht të rëndësishëm: komplimenti duhet të jetë krejtësisht i sinqertë në dukje, pa asnjë gjurmë ironie. Përndryshe, rrezikon vetëm ta përkeqësosh situatën. Nëse përdoret mirë, kjo teknikë e çarmatos kundërshtarin. Barbara Berckhan e krahason

ÇFARË FSHIHET PAS FORCIMIT REKORD TË LEKUT?



TIRANË, 27 KORRIK - Një euro u këmbye këtë javë me vetëm 93.62 lekë, niveli më i ulët historik kundrejt monedhës shqiptare. Në teori, një lek më i fortë do të duhej t'i bënte më të lira mallrat e importuara, t'i ulte kostot për bizneset dhe ta rriste fuqinë blerëse të qytetarëve.

Por, në Shqipëri ndodh e kundërta. Çmimet e ushqimeve vazhdojnë të mbeten ndër më të lartat në rajon, eksportuesit ankohen se po humbasin konkurrueshmërinë, ndërsa ekonomistët vënë në pikëpyetje nëse shpjegimet zyrtare mjaftojnë për të kuptuar pse leku është forcuar aq shumë.

Debati është shndërruar në një përplasje mes qeverisë, opozitës dhe ekspertëve të ekonomisë. Qeveria ka argumentuar se forcimi i lekut është rezultat i hyrjes së sasive të mëdha të valutës në ekonomi, të nxitura nga turizmi, investimet e huaja dhe remitencat. Opozita, në anën tjetër, pretendon se kursi i këmbimit ndikohet edhe nga ekonomia joformale dhe pastrimi i parave. Ndërsa një pjesë e ekonomistëve thonë se të dhënat zyrtare nuk e shpjegojnë plotësisht këtë fenomen dhe kërkojnë një analizë më të thellë të burimeve të valutës që hyn në vend.

Për kryeministrin Edi Rama nuk është euroja ajo që është dobësuar, por leku që është forcuar. “Forcimi i lekut është sukses për ekonominë shqiptare. Është tregues kokëfortë i rritjes së ekonomisë”, ka deklaruar ai ditët e fundit, duke e lidhur këtë zhvillim kryesisht me rritjen e të ardhurave nga turizmi.

Shifrat zyrtare e mbështesin këtë argument. Sipas Bankës së Shqipërisë, vizitorët e huaj shpenzuan rreth 5.7 miliardë euro në Shqipëri gjatë vitit 2025, rreth 15 për qind më shumë se një vit më parë.

Ministria e Financave e Shqipërisë ka raportuar, gjithashtu, 1.6 miliard euro

investime të huaja direkte dhe mbi 2 miliardë euro remitenca, të cilat, sipas qeverisë, kanë rritur ndjeshëm ofertën e euros në treg dhe kanë çuar në forcimin e lekut. Por, opozita ka thënë se një monedhë më e fortë nuk është domosdoshmërisht shenjë e një ekonomie më të fortë, duke argumentuar se ky zhvillim nuk është shoqëruar me rritje të prodhimit, produktivitetit apo eksporteve. Sipas saj, forcimi i lekut nuk reflekton gjendjen reale të ekonomisë shqiptare.

A mjaftojnë turizmi, investimet dhe remitencat për ta shpjeguar? Për qeverinë, përgjigjja është po. Kryeministri Rama hedh poshtë pretendimet se pas forcimit të lekut fshihen kryesisht para me origjinë të dyshimtë. Sipas tij, hyrja e madhe e valutës në ekonomi është rezultat i zhvillimeve të ligjshme, mbi të gjitha, i bumit të turizmit.

“Diskutojmë që këtu ka një lavatriçe parash të pista, por kush do të na linte ne të vazhdonim të mbyllnim kapitujt me Bashkimin Evropian?”, ka thënë Rama, duke shtuar se zbulimi i rasteve të pastrimit të parave tregon forcimin e institucioneve dhe jo se Shqipëria është një “narkoshtet”.

Opozita e sheh ndryshe situatën. Kreu i Partisë Demokratike, Sali Berisha, ka pretenduar se mbiçmimi i lekut nuk mund të shpjegohet vetëm me turizmin apo investimet, por lidhet edhe me hyrjen e parave nga aktivitetet kriminale. Edhe pse nuk paraqet prova konkrete për këtë pretendim, ai ka argumentuar se flukset e mëdha të euros kanë ndikuar në kursin e këmbimit, pa sjellë përmirësim të mirëqenies së qytetarëve apo të ekonomisë prodhuese.

Debati nuk është i ri. Prej vitesh, ekonomia joformale dhe rreziku i pastrimit të parave kanë qenë pjesë e diskutimeve për ekonominë shqiptare. Raporti i fundit i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit

të Organizuar (SPAK) tregon se vetëm gjatë vitit 2025 janë sekuestruar dhe konfiskuar rreth 45.4 milionë euro pasuri, ndërsa sektori i ndërtimit dhe pasuritë e paluajtshme identifikohen si ndër fushat me ekspozimin më të lartë ndaj pastrimit të parave. Megjithatë, vetë këto të dhëna nuk provojnë se kursi i këmbimit është ndikuar nga aktivitetet kriminale.

Pikërisht për këtë arsye, disa ekonomistë argumentojnë se debati nuk duhet të mbështetet vetëm te deklaratat politike, por te analiza e treguesve ekonomikë.

Sipas tyre, pyetja kryesore nuk është nëse turizmi ka sjellë më shumë euro në Shqipëri, kjo është e padiskutueshme, por nëse kjo mjafton për të shpjeguar një forcim kaq të madh të lekut.

Ekonomistët: Shifrat nuk e shpjegojnë plotësisht forcimin e lekut

Irena Beqiraj, ish-zëvendësministre e Financave e Shqipërisë, argumenton se analiza e Qeverisë mbështetet vetëm te paratë që hyjnë në vend, por nuk merr parasysh edhe ato që dalin. Sipas saj, nga rreth 5.7 miliardë euro të ardhura nga turizmi gjatë vitit 2025 duhet të zbriten rreth 3.06 miliardë euro që shqiptarët shpenzuan jashtë vendit.

Edhe te investimet e huaja, ajo sheh një dallim të rëndësishëm. Një pjesë e madhe e tyre, ka thënë Beqiraj, nuk paraqet kapital të ri që ka hyrë në Shqipëri, por fitime që kompanitë e huaja kanë zgjedhur t'i riinvestojnë në vend.

Ndërsa remitencat, sipas saj, janë rritur, por jo në nivele që do të shpjegonin një ndryshim kaq të madh të kursit të këmbimit. “Për mua, 25 deri në 40 për qind e mbiçmimit të lekut mbetet e pashpjeguar nga turizmi, investimet e huaja dhe remitencat”, ka thënë Beqiraj.

Qëndrim të ngjashëm ka edhe

ekonomisti Pano Soko. Ai ka argumentuar se, nëse forcimi i lekut do të ishte rezultat i ekonomisë reale, kjo do të reflektohej para së gjithash te bilanci tregtar. “... por, të dhënat tregojnë se bilanci është në deficit dhe diferenca mbetet thuajse e njëjtë që prej vitit 2013, kur euroja këmbuhej me 140 lekë. Nëse ky raport mes importit dhe eksportit nuk ka ndryshuar, edhe kursi i këmbimit do të mbetej i njëjtë”, ka thënë Soko për “Radion Evropa e Lirë”.

Sipas tij, as investimet e huaja nuk e shpjegojnë këtë zhvillim. “Nëse do të shihnim vetëm këtë tregues, euroja madje do të duhej të ishte forcuar, sepse investimet e huaja nga viti 2015 deri më sot kanë rënë”, ka thënë ai.

Atëherë, nga vjen pjesa tjetër e valutës që ushtron presion mbi kursin e këmbimit?

Beqiraj ka thënë se të dhënat zyrtare të ekonomisë nuk e shpjegojnë plotësisht forcimin e lekut dhe se kjo mund të nënkuptojë ekzistencën e flukseve të tjera valutore që nuk pasqyrohen në statistikat zyrtare. Soko shkon një hap më tej, duke argumentuar se ekonomia joformale dhe paratë me origjinë kriminale kanë një ndikim të rëndësishëm në tregun valutë, pasi për kursin e këmbimit rëndësi ka sasia e euros që hyn në qarkullim, pavarësisht burimit të saj.

Leku forcohet, por pse nuk ndihet në xhepin e qytetarëve?

Në teori, një monedhë më e fortë duhet të sjellë përfitime të prekshme për ekonominë. Importet bëhen më të lira, kostot e bizneseve ulen dhe kjo, me kalimin e kohës, duhet të reflektohet edhe në çmimet që paguajnë konsumatorët. Por, ekonomistët thonë se kjo nuk ka ndodhur në Shqipëri. Një studim i fundit mbi çmimet tregon se në

vitin 2024 çmimet e ushqimeve dhe pijeve joalkoolike në Shqipëri arritën në 100 për qind të mesatares së Bashkimit Evropian, nga 68 për qind sa ishin në vitin 2012. Sipas autorëve të studimit, Shqipëria ka regjistruar rritjen më të madhe të çmimeve të ushqimeve në rajon, ndonëse të ardhurat e familjeve shqiptare mbeten shumë më të ulëta se në vendet e BE-së. Azmi Stringa, një nga autorët e studimit, ka thënë se forcimi i lekut nuk është përkthyer në ulje çmimesh për konsumatorët. “Një lek më i fortë duhej të sillte përfitime për qytetarët dhe ekonominë prodhuese, por kjo nuk ka ndodhur”, ka thënë Stringa për “Radion Evropa e Lirë”.

Ai ka shtuar se problemet strukturore të ekonomisë shqiptare, si konkurrenca e dobët, mungesa e transparencës në treg dhe mbikëqyrja e kufizuar, kanë penguar që efekti pozitiv i kursit të këmbimit të arrijë te konsumatori.

Edhe Beqiraj i referohet të njëjtit studim për të ilustruar paradoksin. Sipas saj, çmimet e ushqimeve në Shqipëri janë tashmë të krahasueshme, madje në disa raste edhe më të larta se në vende si Holanda apo Spanja, megjithëse këto vende kanë të ardhura dhe nivel jetese dukshëm më të lartë. “Rezultatet e studimit tregojnë se çmimet e ushqimeve në Shqipëri janë rritur më herët, më shpejt dhe në mënyrë më frekvente se në vendet e rajonit, edhe pse leku është vlerësuar me rreth 30 për qind gjatë dekadës së fundit”, ka thënë Beqiraj.

Ndërkohë, një lek më i fortë nuk prek të gjithë njësoj. Ekonomistët kanë thënë se ndër më të goditurit janë eksportuesit, të cilët të ardhurat i sigurojnë në euro, ndërsa pagat, energjinë, qiratë dhe shumicën e kostove i paguajnë në lekë. Me zhvlerësimin e euros, fitimet e tyre tkurren dhe produktet shqiptare bëhen më pak konkurruese në tregjet ndërkombëtare. Sipas Sokos, të njëjtin presion e ndien edhe sektori i turizmit. “Turizmi i bën ofertat në euro dhe me rënien e saj do të detyrohet ta rrisë çmimin. Por, një çmim më i lartë nuk e bën atë konkurrues me vende të tjera. Nëse kjo rënie e euros vijon, shumë operatorë turistikë do të detyrohen të dalin nga tregu”, ka thënë Soko.

Përfitues, nga ana tjetër, janë ata që blejnë mallra jashtë vendit ose kanë detyrime financiare në euro. Bizneset importuese paguajnë më pak për produktet që sjellin nga jashtë, ndërsa qytetarët që kanë kredi në euro i shlyejnë ato me më pak lekë se disa vite më parë. Edhe shteti përfiton, pasi një pjesë e borxhit publik është marrë në euro dhe sot shlyhet me një kurs këmbimi më të favorshëm.

6 STRATEGJI. SI TA KESH GJITHMONË PËRGJIGJEN GATI



Nuk është e lehtë t'i përgjigjesh menjëherë një komenti therës me një kundërpërgjigje të zgjuar. Shpesh mbetemi pa fjalë dhe vetëm më vonë, fatkeqësisht shumë vonë, mendja na sjell përgjigjen që duhej të kishim dhënë në atë moment. Si mund të bëhemi më të zotë në këto situata? Sipas ekspertëve të komunikimit, ekzistojnë gjashtë strategji që mund të na ndihmojnë. Kjo u ndodh të gjithëve. Po debaton me një koleg, biseda nxehet dhe papritur ai të lëshon një batutë të hidhur ose një përgjigje brilante. Ti mbetesh pa fjalë, ndërsa ai buzëqesh triumfues. Pastaj, sapo mbërrin në shtëpi dhe e rikthen skenën në mendje, të vjen ndërmend një përgjigje po aq e zgjuar. Francezët e quajnë këtë fenomen esprit de l'escalier ("shpirti i shkallëve"), një shprehje që përshkruan momentin kur njeriu gjen përgjigjen e duhur vetëm pasi situata ka kaluar.

Shprehjen e krijoi filozofi Denis Diderot (1713–1784) në veprën Paradoksi mbi aktorin: "Një

njeri i ndjeshëm si unë, i tronditur nga argumenti i kundërshtarit, humbet fillin e mendimit dhe e gjen sërish vetëm kur ka zbritur shkallët." Në atë kohë sallonet ku zhvilloheshin pritjet ndodheshin zakonisht në katin e dytë dhe "të zbrisje shkallët" nënkuptonte se po largoheshe nga mbrëmja. Edhe filozofi tjetër francez, Jean-Jacques Rousseau, në veprën Rrëfimet, pranon se shpesh binte në këtë kurth dhe madje ia atribuonte këtij fenomeni famën e tij si njeri i tërhequr dhe i vështirë në marrëdhënie. Atëherë, si duhet të reagojmë përballë një komenti të papërshtatshëm ose një vërejtjeje fyese? Sipas ekspertes së komunikimit Barbara Berckhan, po. Ajo propozon gjashtë strategji që kanë rezultuar efektive gjatë studimeve të saj.

Strategji e parë: Kundërpërgjigje

Kjo strategji konsiston në përgjigjen ndaj një komenti fyjes pa hyrë në konflikt me per-

sonin që e ka bërë. Në vend që të kundërshtosh, thjesht përsërit fjalët që të goditën dhe kërko një shpjegim. Shembull: Marta pyet Lukën si i rri një fustan i ri. Luka përgjigjet: "Të rri ngjitur pas trupit si lëkura e një sallami." Reagimi instinktiv i Martës mund të ishte ta ofendonte. Por, duke përdorur strategjinë e kundërpërgjigjes, ajo mund të thotë: "Çfarë do të thuash me 'si lëkura e një sallami'?" Në këtë mënyrë mund të zbulohet se Luka nuk kishte për qëllim ta fyente, por thjesht po përdorte një krahasim të pazakonit. Kjo strategji i jep mundësi bashkëbiseduesit të sqarojë qëndrimin e tij dhe shmang përshkallëzimin e konfliktit. Berckhan paralajmëron: "Kjo nuk duhet të jetë një kundërpërgjigje agresive, si: 'Çfarë deshe të thuash me këtë? Do të më acarosh?'" Përkundrazi, duhet bërë me qetësi dhe me interes të sinjertë për të kuptuar, duke ruajtur një qëndrim të qetë dhe jo armiqësor.

Strategji e dytë: Heshtja

Përballë një batute të pahijshme, ndonjëherë është shumë më mirë të mos reagosh fare. Kështu shmangen pasojat e pakëndshme dhe kundërshtari mbetet i çarmatosur. Siç thotë Berckhan: "Duke heshtur, e lëmë tjetrin vetëm me fjalët e veta, pa i dhënë kënaqësinë që të na shohë duke reaguar." Heshtja është një mjet i fuqishëm sepse tregon se kemi zgjedhur me vetëdije të mos i kushtojmë rëndësi komentit. Ajo bëhet edhe më efektive nëse shoqërohet me një gjest të papritur dhe të qetë. Për shembull: të tundësh kokën sikur po e përshëndet; të tregosh me gisht nga dritarja ose qielli, sikur po i tërheq vëmendjen për diçka tjetër. Në këtë mënyrë, personi që bëri komentin mbetet pa reagimin që priste dhe shpesh nuk di më si ta vazhdojë sulmin.

Strategji e tretë: Faza standarde

Një tjetër mënyrë është t'i përgjigjesh një komenti fyjes me

një frazë të zakonshme si: "Po mirë?" "Ah, po?" "Vërtet?" "E kuptoj."

Këto përgjigje përcjellin një indiferencë të plotë ndaj fjalëve të tjetrit. Pikërisht për këtë arsye, komentet fyese fillojnë të duken të pavlera dhe nuk meritojnë më vëmendje. Në këtë mënyrë, personi që kërkon të provokojë nuk arrin qëllimin e tij dhe kupton se fjalët e tij nuk kanë asnjë ndikim.

Strategji e katërt: Lavdërimi

Kjo strategji, shumë efektive nëse përdoret siç duhet, konsiston në t'i përgjigjurit ndaj një komenti arrogant me një kompliment ose një fjalë të sjellshme. Megjithatë, ka një kusht të rëndësishëm: komplimenti duhet të jetë krejtësisht i sinjertë në dukje, pa asnjë gjurmë ironie. Përndryshe, rrezikon vetëm ta përkeqësosh situatën. Nëse përdoret mirë, kjo teknikë e çarmatos kundërshtarin. Barbara Berckhan e krahason



me një “përqaftim”: “Në thelb, një person arrogant pret që të tjerët t’ia njohin epërsinë. Kur kjo ndodh menjëherë, ai shpesh mbetet i hutuar.” Shembuj të komplimenteve që mund ta çarmatosin bashkëbiseduesin janë: “Më pëlqen sa shumë di.” “Duket që e njeh mirë këtë temë.” “Është kënaqësi të të dëgjosh.” “Duket menjëherë që ke përvorje.” Kjo strategji është veçanërisht e dobishme me njerëzit mendjemëdhenj, ata që kanë nevojë të ndihen superiorë. Megjithatë, mos e tepro. Synimi nuk është ta bësh lavdërimin të duket artificial, por ta lësh tjetrit të pasigurt nëse komplimenti është apo jo i sinqertë.

Strategji e pestë: Ndrysho temën

Një tjetër strategji shumë efektive është të mos iu përgjigjesh fare asaj që tha tjetri, por ta çosh bisedën në një drejtim krejt tjetër. Imajjinoni këtë situatë në një zyrë. Një klient thotë: “Duhet ta pranoj se deri tani në këtë kompani kam pasur punë vetëm me idiotë. Më vjen mirë që po flas për herë të parë me dikë që është vetëm gjysmë idiot.” Edhe pse tundimi është t’i

përgjigjesh me të njëjtën monedhë, Berckhan sugjeron diçka krejt tjetër. Mund të thuash: “Meqë ra fjala, ju kam njoftuar që kemi kaluar në një sistem të ri mbështetës prej alumini?” Ndryshimi i menjëhershëm i temës e rikthen dialogun në terrenin që kontrollon ti, pa hyrë në një përplasje personale. Sigurisht, mund të përdoren edhe ndryshime më provokuese të temës, si: “Po mendoja se ju jeni më i sjellshëm se kaq.” “Ndërkohë që po flisnit, po mendoja...” “Ju kanë thënë ndonjëherë se batuta të tilla nuk i bëjnë mirë trurit?” Por Berckhan paralajmëron se këto përgjigje e tregojnë se komenti të ka prekur dhe mund ta çojnë bisedën në një konflikt të panevojshëm.

Strategji e gjashtë: Proverbi absurd

Kjo është ndoshta strategjia më e pazakontë. Ideja është ta hutosh plotësisht bashkëbiseduesin duke iu përgjigjur me një proverb ose shprehje që nuk ka asnjë lidhje me atë që sapo tha. Për shembull, nëse dikush thotë: “A e quan ti këtë një marrëdhënie?” Mund të përgjigjesh: “Kush ngrihet herët, Zoti e ndihmon.”

Ose: “Qeni që leh nuk kafshon.” Duke iu përgjigjur me një fjali krejt pa lidhje, është sikur po i thua tjetrit se edhe ajo që sapo tha nuk kishte kuptim. Nëse ai mbetet i habitur, mund të shtosh me qetësi: “Mendoje edhe një herë atë që desha të thosha. Besoj se do ta kuptosh.” Sipas Berckhan, kjo teknikë është shumë e fuqishme sepse shkakton humor në vend të zemërimit. Për më tepër, të lejon të reagosh pa zbritur në nivelin e personit tjetër, duke lënë përshtypjen e një njeriu të qetë dhe të mençur.

Zgjidhja e fundit

Filozofi Arthur Schopenhauer kishte një këndvështrim më të ashpër. Ai shkruante: “Kur kupton se kundërshtari yt është më i fortë dhe se do të humbësh debatin, bëhu personal dhe fyeje.” Nuk është pikërisht këshilla që do të prisnim nga një filozof. Por, siç përfundon artikulli me humor: Kur s’ka rrugë tjetër... ndonjëherë ndodh edhe kjo!

Schopenhauer: Arti i të paturit gjithmonë të drejtë

Ky është titulli i veprës së filozofit Arthur Schopenhauer, Arti për të pasur gjithmonë të

drejtë, ku ai përshkruan disa nga taktikat më të njohura që përdoren në debatet verbale.

Përgjithësimi

Kjo taktikë konsiston në interpretimin e fjalëve të kundërshtarit në mënyrën më të përgjithshme të mundshme. Sa më i përgjithshëm të bëhet një pohim, aq më lehtë mund të sulmohet.

Shembull: – “Italianët janë shumë të mirë në artin e dublimit.” – “Po, por arti italian sot është shumë në rënie.” Kjo taktikë nuk sulmon idenë, por personin që e shpreh atë, pavarësisht nga vlefshmëria e argumentit.

Shembull: – “Mendoj se Nietzsche ishte një filozof i madh.” – “Idetë e Nietzsche-s janë të gabuara. Të gjithë e dinë se ai vdiq i çmendur.”

Kthimi i argumentit kundër kundërshtarit

Konsiston në përdorimin e argumentit të kundërshtarit kundër vetë atij.

Shembull: – “Është ende fëmijë, duhet t’ia


falim.” – “Pikërisht sepse është fëmijë, duhet korrigjuar që të mos krijojë zakone të këqija.” Kjo teknikë synon të rrëzojë argumentin e kundërshtarit duke iu referuar autoritetit të një figure ose burimi të njohur.

Shembull: – “Të gjithë e dinë që Toka ka formë eliptike.” – “Po, por sipas Biblës Toka është e sheshtë dhe nuk mund të mos e marrësh parasysh Fjalën e Zotit.”

Kjo taktikë pretendon se një ide është e vërtetë vetëm sepse shumë njerëz besojnë në të.

Shembull: – “Teoria X nuk është bindëse.” – “Nuk është e vërtetë. Shumë njerëz besojnë se ajo është e saktë.”

Schopenhauer i përshkruante këto si marifete retorike që përdoren shpesh për të fituar një debat, jo domosdoshmërisht për të mbrojtur të vërtetën. Për këtë arsye, libri mbetet edhe sot një nga tekstet më të njohura mbi psikologjinë e debatit dhe manipulimin retorik. / bota.al



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Basketbollistët e rinj të Kosovës, kampionë në Divizionin C

SHKODËR, 27 KORRIK - Përfaqësuesja e Kosovës U18 në konkurrencën e meshkujve është shpallur kampione e FIBA U18 EuroBasket 2026, Divizioni C, pasi në finalen e zhvilluar në Shkodër e ka mposhtur bindshëm

Andorrën me rezultat 91:49. Basketbollistët e rinj të Kosovës kanë zhvilluar një paraqitje dominuese, duke e kontrolluar takimin nga fillimi deri në fund dhe duke e kurorëzuar me trofe një kampionat të shkëlqyer.

“Dardanët” e rinj e kanë përfunduar turneun me bilanc perfekt, duke regjistruar pesë fitore në po aq ndeshje, pa pësuar asnjë humbje. Gjatë gjithë kampionatit ata kanë dëshmuar nivel të lartë loje,

disiplinë dhe karakter, për t'u ngjitur në majën e Divizionit C. Ky sukses përfaqëson një arritje të rëndësishme për basketbollin e Kosovës dhe një tregues premtues për të ardhmen e gjeneratave të reja të këtij sporti.



SUPERLIGA E KOSOVËS NIS ME DERBIN PRISHTINA - BALLKANI

PRISHTINË, 27 KORRIK - Është hedhur shorti për xhirot e para të edicionit të ri 2026/27 në Superligën e Kosovës. Në javët e para të kampionatit priten disa përballje interesante dhe mjaft të forta. Vëmendja kryesore në xhiron hapëse do të jetë te përballja në mes të Prishtinës dhe Ballkanit, të cilat pritet t'i synojnë objektivat më të larta në këtë edicion.

Një tjetër duel që pritet të sjellë emocione është edhe ai në mes të Dritës dhe Llapit. Në ndeshjet e tjera Malisheva do të udhëtojë për përballje me

skuadrën e sapopromovuar në elitën e futbollit, Vushtrrinë. Ndërkohë, Gjilani do të jetë mysafir i Feronikelit '74, ndërsa në sfidën tjetër do të përballen Drenica dhe Dukagjini. Sezoni vjeshtor i Superligës së Kosovës do të nisë më 15 gusht, ndërsa pjesa e parë e kampionatit do të përfundojë më 20 dhjetor. Që në start, kampionati pritet të sjellë rivalitet të fortë, me skuadrat që do të kërkojnë ta nisnin edicionin e ri me rezultate pozitive dhe të pozicionohen sa më mirë në tabelën e klasifikimit.



“ÇËSHTJE E MBYLLUR”, TRAJNERI I SUNDERLANDIT I DËRGON MESAZH TË QARTË CHELSEAT PËR GRANIT XHAKËN

SUNDERLAND, 27 KORRIK - Chelsea ka marrë një goditje në përpjekjet për të transferuar Granit Xhakën, pasi trajneri i Sunderlandit, Regis Le Bris, ka bërë të qartë se mesfushori nuk do të largohet nga klubi këtë verë.

Mesfushori shqiptar ishte lidhur me një kalim të bujshëm te Chelsea, ku trajneri Xabi Alonso dëshironte të ribashkohej me ish-lojtarin e tij te Bayer Leverkuseni. Megjithatë, klubet nuk kanë arritur marrëveshje dhe negociatat janë ndërprerë.

Pas humbjes së Sunderlandit në ndeshjen miqësore ndaj Liverpoolit, Le Bris ka konfirmuar se çështja është mbyllur. “Granit Xhaka te Chelsea? Nuk ka asgjë të re. Kjo çështje është e mbyllur. Ai ka qenë shumë i qartë për të



ardhmen. E do Sunderlandin, dëshiron të qëndrojë këtu dhe të ndërtojë të ardhmen me këtë

klub. Është një kapiten i mirë dhe një lider i madh”, ka deklaruar trajneri francez.

Edhe vetë Xhaka ka konfirmuar se nuk ka ndër mend të largohet nga “Stadium of Light”. “Sunderlandi ka qenë shtëpia ime që nga dita e parë. Të gjithë jemi shumë të lumtur. Kam vendosur të qëndroj aty ku jam; gjëja më e rëndësishme është familja. Jam gati të bëj histori me këtë klub”, është shprehur ai.

33-vjeçari i ishte bashkuar Sunderlandit verën e kaluar nga Bayer Leverkuseni, duke u rikthyer në Premierligë pas aventurës së tij shumëvjeçare me Arsenalin. Në sezonin e tij të parë me Sunderlandin, Xhaka ka zhvilluar 36 ndeshje dhe ka shënuar një gol, ndërsa paraqitet e tij kanë ndihmuar skuadrën të sigurojë një vend në Ligën e Evropës për sezonin e ardhshëm.

UEFA i beson Visar Kastratit drejtimin e një tjetër ndeshjeje evropiane

Prishtinë, 27 korrik - UEFA i ka besuar gjyqtarit nga Kosova, Visar Kastrati, drejtimin e një tjetër ndeshjeje në kuadër të raundit të dytë kualifikues të UEFA Conference League, ndërmjet SK Rapidit dhe FC Santa Colomës.

Ndeshja do të zhvillohet nesër (e mërkurë) në “Weststadion” të Vjenës, me fillim nga ora 20:30. Kastrati do të asistohet nga Lumturije Muhadri dhe Bajram Kabashi, ndërsa gjyqtar i katërt do të jetë Eridon Podvorica.

Ky delegim përfaqëson një tjetër vlerësim të rëndësishëm nga UEFA dhe është dëshmi e besimit të vazhdueshëm në profesionalizmin, përgatitjen dhe cilësinë e gjyqtarëve të Kosovës në arenën ndërkombëtare. Me këtë rast, Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) i ka uruar suksese ekipit të gjyqtarëve dhe një paraqitje sa më të mirë në këtë sfidë evropiane.


Rizespori bën ofertë për huazimin e Milot Rashicës

RIZE, 27 KORRIK - Çaykur Rizespor ka bërë hapin e parë për transferimin e Milot Rashicës, duke i dërguar Beshiktasit një ofertë zyrtare për huazimin e sulmuesit të Kosovës. Sipas medieve turke, Rashica është objektiv kryesor i Rizesporit në këtë

afat kalimtar, me drejtuesit e klubit që synojnë ta përforcojnë repartin ofensiv për sezonin e ri. Tashmë pritet vendimi i Beshiktasit, i cili do të përcaktojë nëse do ta lejojë largimin e 30-vjeçarit në formë huazimi. Përvoja dhe paraqitjet e

Rashicës në futbollin turk e kanë bërë atë prioritet për Rizesporin. Megjithatë, klubi ka përgatitur edhe një alternativë në rast se marrëveshja dështon. Sipas mediumit turk “Takagazete”, opsioni rezervë është Jesurun Rak-Sakyi, i cili sezonin e

kaluar ishte pjesë e Rizesporit si i huazuar nga Crystal Palace. Milot Rashica është nën kontratë me Beshiktasin deri në verën e vitit 2027, ndërsa te Rizespori aktivizohet edhe mesfushori i Kombëtares së Shqipërisë, Qazim Laçi.



Duke u bazuar në nenin 7 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr.01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në bashkëpunim me operatorin "Globi Metal" SH.P.K. Lipjan, kërkesa me nr. prot. 26/754/MMPH për t'u pajisje me Lejes Mjedisore, për Qendrën për grumbullimin e mbeturinave metalike, plastike, presimin e tyre dhe grumbullimin e akumulatorëve mbeturinë në Banullë- Lipjan, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për kërkesën për t'u pajisur me Eje Mjeiçore

Njoftohet publiku i interesuar se me datë: 18.08.2026, në ora: 10:00 në hapësirat e Zyreve të "Globi Metal"- Rr. Bajram Gashi nr.296 - Banullë- Lipjan, do të organizohet debat publik nga operatori "Globi Metal" SH.P.K. Lipjan, kërkesa për Leje Mjedisore, me nr. prot. 26/754/MMPH, për Qendrën për grumbullimin e mbeturinave metalike, plastike, presimin e tyre dhe grumbullimin e akumulatorëve mbeturinë në Banullë- Lipjan, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM:

<https://us05web.zoom.us/j/85787903334?pwd=4PaPdkNxi5ay7y00cVo7RAI1k388JD.1>

ID: 857 8790 3334

 Passcode: globimetal

Linku i Komunës së Lipjanit:

Linku i gazetës ditore:

Në linkun e mëposhtëm, mund të gjeni aplikacionin e publikuar në ueb faqe të MMPH-së, për komente të publikut:

<https://mmphi.rks-gov.net/Document?search=MATR>

Pjesëmarrja e publikut është e mirëseardhur dhe e rëndësishme për procesin.

Me respekt,

Globi Metal sh.p.k

Duke u bazuar në nenin 7 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr.01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MMPHI – Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në bashkëpunim me operatorin "Zhuri" SH.P.K. Tranziti, Prizren, kërkesa me nr. prot. 25/3870/242/MMPH-DMM për vazhdim të Lejes Mjedisore, për veprimtarinë: shfrytëzim i gurit gëlqeror në Zhur- Prizren, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për kërkesën për t'u pajisur me Leje Mjedisore

Njoftohet publiku i interesuar se me datë: 21.08.2026, në ora: 11:30, në hapësirat e zyreve të ZHURI Sh.p.k – fshati Zhur, Kreks , do të organizohet debat publik nga operatori "Zhuri" SH.P.K. Tranziti, Prizren, kërkesa për vazhdim të Leje Mjedisore, me nr. prot. prot. 25/3870/242/MMPH-DMM, për veprimtarinë: shfrytëzim i gurit gëlqeror në Zhur- Prizren, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM:

ID: 893 1017 2139

 Passcode: j7YuLt

Linku i Komunës së Prizrenit:

Linku i gazetës ditore:


Në linkun e mëposhtëm, mund të gjeni aplikacionin e publikuar në ueb faqe të MMPH-së, për komente të publikut:

<https://mmphi.rks-gov.net/Document?search=MATR>

Pjesëmarrja e publikut është e mirëseardhur dhe e rëndësishme për procesin.

Me respekt,

ZHURI Sh.p.k



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Cjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Qamil Karavidaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Gjergj Kastrioti" në Mazdrek.

- Valmir Karavidaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Gjergj Kastrioti" në Mazdrek.

- Elton Halili shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së 11 të shkollës së mesme të lartë të mjekësisë "Dr. Xheladin Deda".

- Istref Hysni Nebiu shpall të pavlefshme Diplomën e Inxhinier i Diplomuar i Makineris në UB-me nr. 332.

- Shkendije Lushaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.l.m."Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Maurita Koca nga Bishtazhini KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit "Hajdar Duishi" Gjakovë.

- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, pent-house. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

